



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit me Karakter Profesional në  
“Teknikë Dentare”**

**ofruar nga**

**Institucioni i Arsimit të Lartë AKADEMIA “IVODENT”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Merita Bardhoshi

2. Dr. Alba Koshovari

Maj 2023

**RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**  
**Për programin e studimit me karakter profesional në “Teknikë Dentare”, ofruar nga Institucioni**  
**i Arsimit të Lartë AKADEMIA “IVODENT”**

Nr.		
1	IAL aplikues:	AKADEMIA “IVODENT”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Ortodoncisë (Fakulteti i Teknikave Dentare)
3	Emërtimi i programit të studimit:	Program me karakter profesional në “Teknikë dentare”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 189, datë 03.07.2020
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Program i ri
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	5
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2021-2022 8 PAE / 4PAK 2022-2023 13 PAE / 6 PAK
18	Numri i studentëve:	2020-2021 11 studentë 2021-2022 24 studentë 2022-2023 30 studentë
19	Komente / të tjera:	-

*Ullay* *Merita*

## PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROÇES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikon se programi i studimit me karakter profesional në "Teknikë Dentare" (DPTD) ofrohet nga Departamenti i Ortodoncisë, Fakulteti i Teknikave Dentare pranë Akademisë Ivodent. Ky program është miratuar me vendim të Senatit Akademik të AI nr. 42, datë 10.02.2020, hapur me Vendim të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 189, datë 03.07.2020 dhe i nënshtrohet për herë tëproçesit të akreditimit.


Programi DPTD ka nisur funksionimin e tij në vitin akademik 2020-2021 dhe i përket nivelit të 5-të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Programi ofron njohuri me karakter profesional për teknikët dentarë, duke i përgatitur ata profesionalisht për të punuar në laboratorët dentare. Në përfundim të formimit të tyre studentët janë të aftë të prodhojnë proteza dentare të lëvizëshme totale apo të pjesëshme, ura dhe kurora fikse, provizore apo të përhershme si edhe aparate të lëvizëshme ortodontike. Për të kuptuar mbi baza shkencore protokollet që ndiqen në laborator, studentët formohen paraprakisht konform planit mësimor të vitit të parë në module si "Anatomia Dentare", Njohuri të Materialeve Dentare Ndihmëse dhe me Biopërshtatshmëri", "Anatomi", "Histologji dhe Biologji e Qelizës", e "Art Modelimi", të cilat mundësojnë gjykimin e saktë mbi formën dhe funksionimin si një kompleks të pjesëve përbërëse të hapësirës orale. Modulet e mëtejshme si "Teknika e Protezave I & II" apo "Teknika e Urave e Kurorave I & II" pajisin studentët me njohuri e aftësi praktike mbi arrijtjen e formës dhe funksionit të dhëmbëve, përgatitjen e modeleve prej allçie, proçedurat e prodhimit të protezës totale të lëvizëshme etj, duke krijuar një raport 50-50% të kohës ndërmjet teorisë dhe praktikës gjatë vitit të parë.

Gjatë vitit të dytë të studimeve modulet "Teknika e Protezave III & IV" apo "Teknika e Urave e Kurorave III & IV" janë më shumë të orientuara nga laboratori dhe praktika mësimore, ku studentët aftësohen në krijimin e protezave tëlëvizëshme totale ose të pjesëshme dhe urave fikse prej metal-qeramike.

Këto punime dentare përfaqësojnë rreth 60% të atyre që ofrohen në dentistri brenda dhe jashtë vendit. Për zhvillimin e mëtejshëm profesional të këtyre specialistëve ofrohen kurse të mëtejshme formimi, në të cilat ata marrin njohuri të përditësuar.

Programi është mjaft i kërkuar nga tregu i punës, jo vetëm brenda vendit, por edhe jashtë tij dhe eksperiencat e para tregojnë punësim 100% dhe nevojë në rritje për këta specialistë.

Programi i studimit me karakter profesional në "Teknikë dentare" është i ri, i liçensuar në vitin 2020, dhe akreditohet për herë të parë. Institucioni ka aplikuar për akreditimin e tij në përputhje me proçedurat e vendosura nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit të Lartë të Shqipërisë dhe bazuar në Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë miratuar me VKM Nr. 824, datë 24.12.2021.




## PËRSHKRIMI I PROÇESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhet nga Prof. Merita Bardhoshi, Dr. Alba Koshovari dhe përfaqësuesja e ASCAL, znj. Endra Velaj.

Grupit të vlerësimit të jashtëm i ofrohet i gjithë dokumentacioni i nevojshëm nga ASCAL për Institucionin aplikues për akreditim. GVJ u njohme me programin e studimit profesional në ciklin 2 vjeçar të studimit dhe hartimin e RVB, pedagogët hartues, lëndët dhe syllabuset.

Grupi realizoi vizitën në institucion, ku u njoh me infrastrukturën dhe materialet laboratorike të vëna në shërbim të studentëve, me personelin akademik mjekë dhe personelin akademik laborantë, me procedurat e rekrutimit të tyre, si dhe sqaroi një sërë pyetjesh që grupi kishte lidhur me kriteret dhe standardet sipas udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve. Një vëmëndje e veçantë, i'u kushtua edhe takimit me studentë të vitit të parë dhe të vitit të dytë të programit që është në proces akreditimi. GVJ u njoh me aktivitetet e tyre të organizuara nga institucioni.

Akademia Ivodent ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me një numër të konsiderueshëm institucionesh të arsimit të lartë, ndërkombëtare dhe vendase si; Fakulteti i Mjekësisë Dentare/Universiteti i Mjekësisë i Tiranës, Universiteti Aldent, Albanian University, Fakulteti i Stomatologjisë Pancevo (Serbi) etj, në funksion të bashkëpunimit në fushën e shkëmbimeve akademike etj. Në zbatim të strategjisë së zhvillimit të institucionit dhe objektivave të procesit mësimor, akademia ka shtuar përpjekjet për të krijuar lidhjet e duhura me institucione të ndryshme. Për realizimin dhe përmirësimin e programit Akademia Ivodent ka marrëveshje edhe me qendra të mëdha dentare në vend si Armend Topalli (AT Group), e Lionel Jahja (DCA) me qëllim trajnimin profesional të studentëve në Akademi dhe kryerjen e praktikave profesionale. Numri i madh i institucioneve partnere dhe aktiviteti i shtuar veçanërisht me Ivoclar Academy dhe partnerët gjermanë, japin rezultate në formimin e studentëve dhe përmbushjen e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve.





## Vlerësimi i Programit të studimit me karakter profesional në “Teknikë Dentare”

### I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Institucioni i arsimit të Lartë, AI ka si synim formimin e studentëve në fushën e teknikave dentare, duke kontribuar në këtë mënyrë në konsolidimin e dentistrisë në nivel kombëtar. Ky institucion ushtron veprimtarinë e vet bazuar legjislacionit të Arsimit të Lartë, akteve ligjore dhe nënligjore normative të tij. AI ushtron veprimtarinë e vet në përputhje të plotë me ligjin 80/15 për "Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë". Programi i studimit me karakter profesional në Teknikë dentare është miratuar me vendim të Senatit Akademik të AI nr. 42, datë 10.02.2020. Programi ofrohet në përputhje të plotë me interesat kombëtare të vendit, Statutin e saj si dhe rregulloren e programit të studimit. <i>Ref. Statuti i Akademisë Ivodent. Strategjia e Zhvillimit të Institucionit AI. Vendim Senati i AI për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Institucionit AI. Rregullore e Përgjithshme Ivodent. Urdhër i akreditimit të parë institucional dhe programit. Urdhër Ministri për miratimin e Statutit të AI. Vizita në institucion. Takimi me Drejtuesit.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Akademia Ivodent në përputhje dhe në zbatim të misionit dhe qëllimit të Akademisë Ivodent ka hartuar Programin e studimit me karakter profesional në "Teknikë dentare". Ky institucion është gjithmonë në rritje cilësore bazuar edhe në kërkesat e tregut në vendin tonë, veç programeve ekzistuese në Bachelor dhe Master Profesional që kanë si pikësynim avancimin në fushën e dentistrisë, përparimin e profesionit të teknikut dentar, duke synuar më tej në Master Shkencor. <i>Ref. Statuti i Akademisë Ivodent. Strategjia e Zhvillimit të Institucionit AI. Vendim Senati i AI për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Institucionit AI. Vizita në institucion. Takimi me Drejtuesit.</i>
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	Me një eksperiencë shumëvjeçare qysh prej vitit 2004, Akademia Ivodent jep kontribut të veçantë në fushën e edukimit të teknikave dentare. Specialistët e formuar në profesionin e teknikut dentar marrin njohuri bashkëkohore me materiale dhe aparatura të viteve të fundit, bashkëpunojnë me mjekët stomatolog dhe janë në gjendje të përballen me probleme të ndryshme të protezimit dentar duke ofruar kështu zgjidhje në situata të veçanta të prodhimit të protezave dentare, aparateve ortodontike sipas fushës dhe drejtimit akademik të vetë IAL. <i>Ref. Strategjia e Zhvillimit të Institucionit AI. Vendim Senati i AI për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Institucionit AI. Rregullore Fakulteti Ivodent. Rregullore e Programit të Studimit TD. Programi TD. Vizita në institucion. Takimi me Drejtuesit.</i>
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit	Duke marrë në konsideratë nevojat në rritje të laboratorëve dentare në Shqipëri

<p>hartohet e zhvillohet mbështetur në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.</p>	<p>për specialistë të teknikave dentare në kushtet e rritjes së turizmit dentar dhe kujdesit për shëndetin oral në vend Akademia Ivodent ka hartuar Programin e studimit me karakter profesional në "Teknikë dentare".</p> <p>Për hapjen dhe funksionimin e këtij programi, u morën parasysh objektivat kombëtare dhe ndërkombëtare të zhvillimit, si dhe u kryen studime tregu ku u morën informacione duke marrë parasysh mendimin e të gjithë aktorëve si stafi akademik, IAL partnere brenda dhe jashtë vendit që ofrojnë programe të ngjashme, shoqata e urdhëra dentare dhe specialistë të fushës.</p> <p>Studentët aftësohen në 2 vite studimi teoriko-praktik. Ata vijnë nga shkolla e mesme pavarësisht rezultateve të arritura, bëhen specialistë në teknikat bazë të laboratorit dentar. Në përfundim të studimeve i ofrohet mbështetje për punësim në fushën përkatëse duke plotësuar mungesat në tregun e punës. Për nxitjen e zhvillimit lokal e kombëtar u morën në konsideratë problemet dhe sfidat e transformimit të shoqërisë shqiptare drejt sfidave të BE, sfidat në sistemin shëndetësor dentar, reformat në sistemin e drejtësisë, zhvillimi ekonomik, arsimit dhe e ardhmja e tij si dhe veprimtari dhe diskutime që lidhen me zhvillimin në fushën e dentistrisë.</p> <p><i>Ref. Analiza e përfitimeve nga Marrëveshjet Institucionale. Analizë e tregut të punës.</i></p> <p><i>Vizita në institucion. Takimi me Drejtuesit.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Përvoja disa vjeçare e AI që daton nga 2004 e në vijim, ka ndikuar në rritjen dhe avancimin e mësimdhënies, infrastrukturës e burimeve njerëzore të nevojshme për ofrimin e këtij programi studimi. Ky institucion shërben si qendër e formimit të teknikëve dentarë, duke u nisur nga nevoja në rritje e tregut për profesionistë të shëndetit oral. Ai vë në dispozicion të studentëve sallat konform parametrave të kërkuar për zhvillimin e mësimin teorik, kryerjen e seminareve, provimeve si dhe pajisjen e laboratoreve dentare me materialet e nevojshme bashkëkohore për realizimin e orëve laboratorike.</p> <p>AI gëzon statusin e institucionit të veçantë i cili realizon në mënyrë optimale programet e studimit në përputhje me kërkesat ligjore por njëkohësisht është fleksibël në lidhje me personelin akademik. Më 2021-2022, Akademia ka angazhuar 17 personel akademik, nga të cilët 10 me kohë të plotë dhe 7 me kohë të pjesshme, ndërsa më 2022-2023 ka angazhuar 19 personel akademik, nga të cilët 13 me kohë të plotë dhe 6 me kohë të pjesshme.</p> <p>AI ka bashkëpunim të suksesshëm me kompanitë Ivoclar-Vivadent AG (Litenshtein), BEGO GmbH (Gjermani), Rhein 83 (Itali), Renfert GmbH (Gjermani) etj., nëpërmjet marrëveshjes me përfaqësuesin e tyre për Shqipërinë "Dorina Mele Co. shpk", dhe qendrat e edukimit dentar pranë tyre si psh Ivoclar Academy për të cilën Akademia Ivodent është partner zyrtar për Shqipërinë. (<a href="https://www.ivoclar.com">https://www.ivoclar.com</a>).</p> <p>Trajnimet, workshopet, përdorimi i materialeve të sapo krijuara nga këto kompani vihen në dispozicion të studentëve dhe stafit duk ndikuar në rritjen e cilësisë së formimit profesional në këtë program studimi.</p> <p><i>Ref. Raport Infrastruktura 2022. Verifikimi i kapaciteteve MAS 21-22. Lista emërore e personelit akademik DP 21-22.</i></p>

<p><b>Kriteri 6.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë/ve përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Studentët formohen në fushën e teknikave dentare, digjitale dhe materialeve dentare dhe janë pjesë e Fakultetit të Teknikave dentare dhe Departamentit të Ortodoncisë. Sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit e direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane ky program hyn në nivelin 5-së të kualifikimit sipas KSHK. Kështu që fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore.</p> <p><i>Vizita në institucion. Takimi me Drejtuesit, stafin, studentët.</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Akademia Ivodent ushtron veprimtarinë dhe aktivitetin e saj në përputhje me ligjin 80/15 për "Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij dhe në përputhje me të ka rishikuar të gjitha aktet normative të tij. Programi i studimit me karakter profesional në "Teknikë dentare" është hartuar në përputhje dhe në zbatim të misionit dhe qëllimit të Akademisë Ivodent. Akademia Ivodent ka eksperiencë të gjatë që prej vitit 2004 në fushën e edukimit të teknikave dentare, duke dhënë një kontribut të rëndësishëm në formimin me njohuritë bashkëkohore në formimin profesionin e teknikut dentar. Programi i studimit është hartuar duke u bazuar në nevojat në rritje të laboratorëve dentare në Shqipëri për specialistë të teknikave dentare në kushtet e rritjes së turizmit dentar dhe kujdesit për shëndetin oral në vend, duke nxitur kështu edhe zhvillimin lokal e kombëtar të vendit. Akademia Ivodent në vite ka arritur të ketë një profil të qëndrueshëm dhe të besueshëm të një institucioni, i cili në historikun e vet mbart disa arritje të rëndësishme që shërbejnë si garanci për zhvillimin e mëtejshëm për vitet në vijim.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard <b>përbushet plotësisht.</b></i></p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përbushet plotësisht</b></p>	
			<p><b>X</b></p>	

**Standardi I.2**

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, dhe mobilitetit.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, AI ka siguruar marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi midis tre njësive bazë që janë përveç Departamentit të Ortodontisë që ofron programin, edhe Departamenti i Protetikës dhe Qendra e Studimit të Teknikave. Diskutimet mbi ngritjen dhe zhvillimin e programit të rikryhen fillimisht në nivel departamenti, në departamentin e Ortodontisë, më pas në Dekanat e Senat. Vendimi i Senatit dërgohet në Bordin e Administrimit për miratim. NJSBC siguron mbarëvajtjen e cilësisë së programit duke hartuar dhe analizuar pyetësorë të posaçëm ku marrin pjesë studentë dhe pedagogë. Diskutimet rreth rezultateve realizohen pas këtij procesi në nivel Departamenti dhe merren masa për përmirësim. Raportet paraqiten të detajuara nga NJSBC.</p> <p><i>Ref. Rregullore Fakulteti Ivodent. Rregullore Departamenti. Vizita në institucion. Takimi me Drejtuesit, stafin, studentët.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.</p>	<p>Për realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni AI vendos marrëdhënie bashkëpunimi me një numër të konsiderueshëm institucionesh të arsimit të lartë ndërkombëtar dhe vendase si Fakulteti i Stomatologjisë Pancevo (Serbi), Fakulteti i Mjekësisë Dentare/Universiteti i Mjekësisë i Tiranës, Universiteti Aldent, Albanian University, etj. në funksion të bashkëpunimit në fushën e shkëmbimeve akademike, etj. Partnerë të tjerë të rëndësishëm si qendra të mëdha dentare në vend si Armend Topalli (AT Group), e Lionel Jahja (DCA) Ivoclar Academy dhe partnerët gjermanë, tregojnë për përpjekjet e mëtejshme për lidhje të reja dhe të qëndrueshme të cilat japin rezultate të mira në zbatim të strategjisë së zhvillimit të institucionit, përmirësimin e programit, formimin e studentëve, përmbushjen e objektivave të procesit mësimor e formues.</p> <p><i>Ref. Analiza e përfitimeve nga Marrëveshjet Institucionale. Vizita në institucion. Takimi me Drejtuesit, stafin, studentët.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme, afatgjata e të qëndrueshme me institucione, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës etj, dhe bashkëpunon me to për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës.</p>	<p>AI ka nënshkruar rreth 15 marrëveshje me klinika/laboratorë dentare brenda vendit për zhvillimin e praktikave profesionale. Për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës AI ka krijuar marrëveshje afatgjata me homologë dhe institucione të huaja dhe vendase të fushës së teknikave dentare. Studentët kanë mundësi të marrin pjesë në konferenca të ndryshme apo në programet e mobilitetit, falë këtyre marrëveshjeve që realizohen edhe shkëmbime të stafit si dhe u mundësojnë studentëve të këtij programi studimi mundësi të reja për realizimin e praktikave profesionale në Gjermani si p.sh në BIOSA, Dreieich dhe ÖSzl,Neu-Isenburg) që prej vitit 2020.</p> <p><i>Ref. Analiza e përfitimeve nga Marrëveshjet Institucionale. Vizita në institucion. Takimi me Drejtuesit, stafin, studentët.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve</p>	<p>NJSBC harton në mënyrë periodike raporte analitike mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. Të dhënat sigurohen nga vlerësimet që grupet e punës të ngritura nga përgjegjësi i Departamentit paraqesin për diskutim në mbledhjen e Departamentit të Ortodontisë. Të dhënat reflektohen në raportin</p>



nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	<p>vjetor ku evidentohen rastet pozitive dhe përfitimet maksimale nga bashkëpunimet e frytshme, gjetjen e bashkëpunëtorëve të rinj në fusha specifike të veprimtarisë së institucionit në shërbim të studentëve dhe stafit.</p> <p><i>Ref. Raporti analitik 21 AI. Raport Analitik 2021-2022. Raporti vjetor 2020-2021. Raporti vjetor 2021-2022.</i></p> <p><i>Takimi me stafin, studentët.</i></p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.</p>	<p>Studentët janë në qëndër të vëmëndjes dhe mbështetjes për punësimin nga Akademia Ivodent e cila paraqet nivelin më të lartë të punësimit të studentëve. Vërehet një shifër superiore e punësimit ku 100% e studentëve të diplomuar në vitet e fundit përfshirë këtu edhe punësimin e tyre në Gjermani ose vende të tjera evropiane.</p> <p>Ekziston një mbështetje e vazhdueshme për punësim të studentëve të cilët nënshkruajnë kontrata punësimi dhe punësohen atje pas studimeve janë marrëveshjet me laboratorët dentare si në Shqipëri edhe në Gjermani, ku studentët kryejnë praktika profesionale.</p> <p>Një suport i veçantë vërehet nga stafi akademik me laboratorët privatë dentar si (Artur Battenfeld, Aurora Sula) duke u kthyer në një faktor punësimi të studentëve. Në Gjermani, Akademia ka nënshkruar edhe një marrëveshje me "BBW Unternehmensberatung", Koblenz, që mundëson njohjen e shpejtë të diplomave.</p> <p>Mbështetja vijon edhe në momentet kur studentët e diplomuar dëshirojnë të hapin ambientet e tyre të sipërmarrjes dhe mund të gjejnë mbështetje në depon dentare "Dorina Mele Co" me të cilën AI ka marrëveshje.</p> <p><i>Ref. Punësimi TD 2020-2022. Kontrata punësimi. Marrëveshje Ivodent.</i></p> <p><i>Takimi me, stafin, studentët.</i></p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Programet e studimeve në Fakultetin e Teknikave Dentare u referohen arritjeve teorike dhe praktike të shkencave në përgjithësi dhe veçanërisht atyre që lidhen me teknologjinë dentare. Akademia Ivodent ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me një numër të konsiderueshëm institucionesh të arsimit të lartë ndërkombëtare. Akademia Ivodent ka nivelin më të lartë të punësimit të studentëve. Janë punësuar 100% e studentëve të diplomuar në vitet e fundit. Veçanërisht i suksesshëm është punësimi i tyre në Gjermani ose vende të tjera evropiane.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi I.3**

**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), funksionon dhe siguron cilësinë e mësimdhënies. AI harton politika dhe procedura në lidhje me sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së brendshme bazuar në legjislacionin në fuqi të Arsimit të Lartë, statutit dhe rregullores së AI.</p> <p>Garantimi i cilësisë së mësimdhënies në përputhje me Standardet shtetërore dhe Kodin e cilësisë është një nga synimet kryesore të AI. Nëpërmjet NJSBC vlerësohet performanca e personelit akademik dhe ndihmës akademik në lidhje me zbatimin cilësor të programit të studimit jo vetëm në aspektin e mësimdhënies, por edhe në atë të kërkimit shkencor, kualifikimit dhe kontributit intelektual në institucion sikundër ka zhvilluar analizat e detajuara për vitet paraardhëse.</p> <p><i>Ref. Statuti i Akademisë Ivodent. Raporti vjetor 2021-2022. Takimi me NJSBC, studentët.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë duke zbatuar një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Sipas Strategjisë së Zhvillimit të AL funksionimi dhe operimi i NJSBC rregullohet nga Statuti i AI dhe Rregullorja e NJSBC.</p> <p>Nëpërmjet organizimit të rregullt të anketimeve rutinë me stafin dhe studentët, NJSBC bashkëpunon me Institute for Quality in Education (iqe.al), analizon dhe vlerëson përfundimet e anketimeve pranë njësive të tjera akademike, administrative dhe studentore. Njësitë bazë sipas problematikave të evidentuara marrin masa të duhura për përmirësime të vazhdueshme.</p> <p><i>Ref. Raport NJSBC mbi Anketat. Marrëveshje Ivodent - IQE. PSV Mbledhje personeli akademik për diskutimin e analizës së cilësisë dhe aplikimit për programin e ri MShk Takimi me NJSBC, studentët.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>NJSBC nëpërmjet ASCAL dhe standardeve shtetërore vlerëson raportet e vlerësimit të jashtëm, bashkëpunon me ekspertët e vlerësimit të jashtëm të angazhuar në proceset e akreditimit të cilët ndihmojnë AI të përmirësojë performancën e saj në tregues të ndryshëm të cilësisë. Një proces i tillë realizohet më 2021 me IQE, po ashtu edhe pjesëmarrja në sondazhin Kombëtar të studentëve në vitin 2022 ku u përfunduan vlerësime analitike e krahasuese të cilat promovojnë dhe përmirësojnë cilësinë në AI. Monitorimi nga NJSBC kryhet nëpërmjet instrumenteve të ndryshëm për sigurimin e cilësisë duke përfshirë stafin, studentët në formim por edhe nga kontakti me alumni.</p> <p><i>Ref. Pyetësi i studenteve AI-IQE. Rezultatet e pyetësit të studenteve AI-IQE. Sondazhi Kombëtar i Studenteve. Takimi me NJSBC, studentët.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira.</p>	<p>Njësitë bazë, NJSBC-ja, nëpërmjet një procesi të vazhdueshëm realizojnë analiza të shoqëruara me të dhëna, të cilat shërbejnë për evidentimin e pikave të forta dhe të dobëta që ka AI. Raportet e gjeneruara analizohen dhe jepen rekomandimet e nevojshme për përmirësimin e pikave të dobëta dhe avancimin në aspektin e cilësisë. NJSBC nxit departamentet përkatëse për implementimin ose përmirësimin e praktikave më të mira mësimore aktuale. AI përdor tregues të matshëm për vlerësimin e mësimdhënies, mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe mangësive.</p> <p><i>Ref. Raporti vjetor 2021-2022. Raport NJSBC mbi Anketat. Rezultatet e pyetësit të studenteve AI-IQE.</i></p>

	<i>Takimi me NJSBC, studentët.</i>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Në AI funksionon Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë, NJSBC. Funksionimi dhe operimi i NJSBC rregullohet nga Statuti i AI dhe Rregullorja e NJSBC, duke patur në fokus Strategjinë e Zhvillimit të AI. Sigurimi i cilësisë është proces i vazhdueshëm. Përveç njësive bazë, NJSBC gjeneron analiza të shoqëruara me të dhëna, të cilat shërbejnë për evidentimin e pikave të forta dhe të dobëta që ka institucioni. NJSBC në bazë të raporteve/analizave jep rekomandimet e saj për nxitjen e praktikave të mira dhe përmirësimin e pikave të dobëta.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard <b>përbushet plotësisht</b>.</i></p>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	
			<b>X</b>	



<b>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	
			<b>X</b>	

*Ally* *Hebru*

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit me karakter profesional, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Bazuar në rregulloren e FTD, programi i studimit është i organizuar në përputhje me strategjinë e AI në lëndë e module. Lëndët janë të kategorizuara mbi bazën e veprimtarive formuese, duke i ndarë ato në lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore dhe plotësuese. Numri më i lartë i krediteve (ECTS) është vendosur në dispozicion të lëndëve karakterizuese si Teknikat e përgatitjes së kurorave dhe urave, Teknika e protezave, Materialet dentare etj., Struktura dhe përmbajtja e Lëndëve janë në përputhje me VKM 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL", e ndryshuar dhe shtesat e udhëzimit përkatës dhe praktikat me të mira evropiane.</p> <p><i>Ref. Strategjia e Zhvillimit të Institucionit AI. Dosja e Programit TD.</i> <i>Takimi me stafin, studentët.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve praktike në një fushë të specializuar profesionale.</p>	<p>Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta, jep njohuri të përparuara në fushën e teknikave dentare. Njohuritë janë të disiplinave të ndryshme si p.sh menaxhimi, etika profesionale, anatomia dhe fiziologjia e gojës, shëndeti oral, gjuha angleze, teoria dhe praktika e protezimit dentar. Studentët marrin njohuri të përparuara akademike dhe shprehi praktike në fushën e dentistrisë dhe teknikave dentare, si dhe të zhvillohet i kuptuari kritik i koncepteve që jepen në teori nëpërmjet aplikimit praktik të tyre në laboratorin dentar. Shpërndarja e orëve është në favor të praktikës në mënyrë që të garantohet zgjidhja e problemeve që lidhen me nivelin, profilin e programit dhe natyrën e punës që parashikohet të kryejë tekniku dentar.</p> <p><i>Ref. Plani mesimor DP TD</i> <i>Takimi me stafin, studentët.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.</p>	<p>Studentët kanë objektiva të qarta, të prekshme dhe të realizueshme për formimin e tyre profesional gjatë procesit të të mësuarit, të fitimit të dijeve dhe kompetencave praktike. Në fund të studimeve ata do të mund të japin zgjidhje situatave për protezat dentare të lëvizshme të pjesshme apo totale, kurorave dhe urave fikse prej materialesh si metali, qeramikat, kompozitet, si edhe nëpërmjet aparateve ortodontike të lëvizëshme e fikse. Studentët ndihmohen të përforcojnë dhe zhvillojnë njohuritë e tyre në formimin në vazhdim. Pas diplomimit studentët punësohen si asistentë në labore dentare, klinika dentare, Qendra Shëndetësore, Spitale etj.</p> <p><i>Ref. Plani mesimor DP TD</i> <i>Takimi me stafin, studentët.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për të gjitha lëndët/modulet, duke përfshirë dhe kreditet për realizimin e praktikës</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional në Teknikë Dentare në AI ka 120 ECTS për 2 vite, i ndarë në 4 semestra. Struktura e tij përban gruplëndët sipas kategorive dhe disiplinave përkatëse ku brenda tyre përfshihen modulet sipas ligjit 80/2015, VKM nr.41. datë 24.01.2018 të</p>

<p>profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>ndryshuar, duke respektuar kështu kuadrin ligjor. Në program parashikohet pjesa praktike si një element shumë i rëndësishëm i formimit. Raporti teori praktikë është 1:1. Në vitin e dytë të studimeve ka të parashikuar 10 kredite dhe provimi përfundimtar ka 5 kredite. Provimi përfundimtar realizohet mbi vlerësimin teorik dhe praktik. Studentët përgatisin një punim individual në laboratorët të cilët ofrojnë të gjitha kushtet për këtë qëllim, për një periudhë 2 javore. Diplomimi kryhet kur studenti ka shlyer të gjitha detyrimet akademike. Ai pajiset edhe me suplement diplome. Vlen për tu përmendur lidhja e teorisë me praktikën si një pikë e fortë që karakterizon këtë program studimi.</p> <p><i>Takimi me stafin, studentët.</i></p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Si një institucion i vogël AI ka nënshkruar me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit një marrëveshje lidhur me përmbushjen e detyrimeve për numrin e stafit të punësuar me kohë të plotë. Përsa i përket financimit, organizimit apo funksionimit Akademia Ivodent nuk ka status të veçantë.</p> <p><i>Ref. Marrëveshja MASR - Ivodent.</i></p> <p><i>Takimi me Drejtuesit.</i></p>		
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit me karakter profesional, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Programi i studimit në Teknikë Dentare është i vetmi me karakter profesional në AI. Për hartimin e këtij programi janë marrë në konsideratë shembuj të programeve të ngjashme të së njëjtës fushë dhe profil, që ofrojnë institucionet e tjera në vendin tonë, bazuar në specifikat që ka AI dhe infrastrukturën për ofrimin e këtij programi.</p> <p><i>Takimi me Drejtuesit.</i></p>		
<p><b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Sipas Udhëzimit të MAS Nr. 31, datë 15.11.2022 për "Proçedurat për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Akademia Ivodent punon për kodifikimin e 3 programeve ekzistuese të studimit, ndër to edhe për DPTD. Kodifikimi i moduleve në lëndët dhe disiplinat përkatëse të programeve të studimit realizohet sipas datëline-ve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe e Sporteve.</p> <p><i>Takimi me Drejtuesit.</i></p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Programi i studimit përmbush detyrimet ligjore të përcaktuara në Ligjin e Arsimit të Lartë, është në harmoni të plotë me misionin e AI. Programi synon aftësimin profesional të studentëve në fushën e teknikave dentare, që përdoren për përgatitjen e protezave dentare dhe aparateve ortodontike në klinikën dhe laboratorin dentar. Programi DPTD përmban të gjithë elementet që përbëjnë strukturën e një programi studimi sipas ligjit. Për hartimin e programit merren për bazë shembuj të programeve që ofrohen nga institucionet e tjera në vend duke retëktuar njëkohësisht edhe specifikat që ka AI dhe infrastrukturën për ofrimin e programit të studimit.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<b>X</b>

**Standardi II.2**

**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>AI ka në përbërje Fakultetin e Teknikave Dentare, 2 Departamente dhe 1 Qëndër kërkimore. Njësia përgjegjëse për zhvillimin e Programit të studimit me karakter profesional në Teknikë Dentare është Departamenti i Ortodoncisë i cili ka detyrim dhe përmbushë të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, standardet akademike si pjesë e kodit të cilësisë. Departamentet kanë në përbërjen e tyre staf me kohë të plotë dhe të pjesëshme. Ata garantojnë cilësi në mësimdhënie e kërkim shkencor. Bazuar në marrëveshjen me Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës, Departamenti i Ortodoncisë si njësi bazë që ofron programin e Teknikëve Dentare ka 1 personel akademik të brendshëm me gradën Doktor, 3 personel akademik me master në Stomatologji, 2 personel të jashtëm akademik me gradën Doktor. Gjatë dy viteve të fundit AI ka rekrutuar staf akademik në përmbushje të nevojave që janë krijuar si rezultat i hapjes/liçensimit të dy programeve të reja. Konformiteti me marrëveshjen me MAS, vërtetohet edhe nga dokumenti i verifikimit të kapaciteteve kryer nga MAS në vitin 2022, ku cilësohet se Akademia përmbush detyrimet sipas marrëveshjes së nënshkruar ku 71 % e ngarkesës mësimore mbulohet nga personeli akademik i punësuar me kohë të plotë. <i>Ref. Verifikim i kapaciteteve - MAS 22-23.</i> <i>Takimi me Drejtuesit.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>AI i jep një rëndësi të veçantë zhvillimit të personelit ndihmës akademik dhe administrativ krahas zhvillimit të personelit akademik. Kjo evidentohet në strategjinë e institucionit 2018-2023. Personeli ndihmës-akademik ka në përbërjen e tij 8 persona që kanë kryer më parë studime 2, 3 dhe 4 vjeçare në teknika dentare apo kanë edhe titull "Mjeshtër i Teknikës Dentare" (ZTM) nga shkolla e Mjeshtërisë për Teknikë Dentare në Gjermani. Personeli ndihmës-akademik angazhohet në mbarëvajtjen dhe zhvillimin e orëve mësimore të programit dyvjeçar. Ata kanë eksperiencë të konsiderueshme nga 5 - 50 vjeçare në laboratorët dentare dhe rrjedhën digjitale të punës në laboratorin dentar. Për realizimin e praktikave mësimore në klinikë dhe laboratorin dentar Departamenti i Ortodoncisë pranë Akademisë Ivodent ka punësuar personel ndihmës-akademik të ri, 3 teknikë dentar me eksperience të gjatë dhe të trajnuar vazhdimisht nga qendra të ndryshme të edukimit dentar si Ivoclar Academy apo 3Shape Academy, duke sjellë për studentët të rejtat dhe eksperincën e gjallë tëpunës së përditshme në laboratorin dentar. <i>Ref. Dokumentacion kualifikimi i personelit të ri ndihmës akademik 22-23. CV stafi akademik PAE TD. CV stafi akademik PAK TD. Lista emërore e personelit akademik DP 21-22.</i> <i>Takimi me stafin.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës</p>	<p>Secili nga programet e studimit në AI ka koordinatorin e tij i cili luan një rol kyç në organizim dhe drejtim, është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikaveprofesionale në përputhje me objektivat e tij, informon vazhdimisht titullarin e departamentit qoftë nëpërmjet takimeve verbale apo në takime të tjera. Programi i studimit me karakter profesional në Teknikë Dentare në AI ka si</p>

për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	koordinator mjeken stomatologe me specializim në Ortodonci Elva Duro, me eksperience 10 vjeçare në teknikatdentare dhe mësimdhënie. <i>Ref. Kontrate per kryerjen e praktikës profesionale TD.</i> <i>Takimi me stafin.</i>		
<b>Konkluzione</b>	<i>Akademia Ivodent është një institucion relativisht i vogël i organizuar në mënyrë të tillë që të mundësojë efikasitet dhe cilësi në veprimtaritë akademike që zhvillon. Në strategjinë e institucionit 2018-2023, krahas zhvillimit të personelit akademik, institucioni i kushton një rëndësi të veçantë zhvillimit edhe të personelit ndihmës akademik dhe administrativ. Për çdo program studimi, Fakulteti cakton çdo vit një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</i>  <i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

### Standardi IL3

**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit me karakter profesional.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit me karakter profesional, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit me karakter profesional është Departamenti i ortodoncisë. Ka rol të rëndësishëm në administrimin e veprimtarive akademike dhe koordinimin e brendshëm, monitorimin e cilësisë së programit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të saj, shpërndarjen e ngarkesës midis lëndëve dhe moduleve si dhe kategorizimin e tyre sipas veprimtarive formuese dhe profilit. Dokumentacioni në këtë departament përfshin materialet informuese kurrikulare, planet mësimore, kalendarin akademik, strukturën e ndarjes së praktikave, periudhën kohore të zhvillimit të secilit prej moduleve të programit të studimit në vitin akademik, etj. <i>Takimi me stafin.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve në kredite, orët në auditor/jashtë auditorit.	Dokumentacionet hartohen në përputhje me legjislacionin në fuqi VKM 41, dt.24.01.2018, e ndryshuar. Plani mësimor si pjesë reflektuese e programit paraqet një informacion të detajuar mbi numrin e Lëndëve, moduleve, kategorinë nga A-E, numrin e krediteve, orët në auditor dhe jashtë auditorit, tipet e veprimtarive të parashikuara dhe ngarkesën respektive të tyre. <i>Ref. Plani mesimor DP TD.</i> <i>Takimi me stafin.</i>
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët, që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit	Programi i studimit në Teknikë Dentare me karakter profesional në AI.përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët. Materialet janë të rregullara dhe paraqiten në një dosje të veçantë ku gjenden kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve, detyrimet përmblyllëse etj.

dhe ekuivalentimit të studimeve.	<p>AI në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e Akademisë, rishikon çdo vit akademik kriteret specifike në varësi të aplikimeve, specifikeve që ka institucioni, kërkesat e programit të studimit dhe udhëzimeve nga Ministria përgjegjëse për arsimin e lartë.</p> <p><i>Ref. Dosja e Programit TD. Rregullore e Programit të Studimit TD</i> <i>Takimi me stafin, sekretarinë.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Në një dosje të veçantë gjenden syllabuset për secilin modul për vitin e parë dhe të dytë për programin e studimit në Teknikë Dentare me karakter profesional në AI. Janë hartuar sipas kërkesave të VKM 41, dt.24.01.2018. Syllabusi përmban komponentë të rëndësishëm si titulli i Lëndës dhe moduli përkatës, qëllimi, objektivat e Lëndës/modulit, ngarkesën, tematikat, orët teorike, seminarët, laboratorët, ushtrime, detyra/projekte, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit, literaturën, detyrimet e studentit në lidhje me frekuentimin dhe testimin, vlerësimin përfundimtar të tyre në përputhje me formatet e miratuara. Syllabuset firmosen nga titullari i Lëndës dhe përgjegjësi i Departamentit të Ortodoncisë.</p> <p><i>Ref. Vendim Senati për hapjen e Programit DP TD. Programi TD.</i> <i>Takimi me stafin.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në njësinë bazë.</p>	<p>Në fillim të çdo viti akademik në Akademinë Ivodent miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në njësinë bazë. Tre programet e studimit që ofron rishikohen, analizohen në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm, në përputhje me nevojat e diktuar nga studimi i tregut të punës bazuar në zhvillimin ekonomik, demografik dhe teknologjik të vendit si dhe në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi, në mbështetje të ligjit Nr. 80/2015, si VKM Nr.41, datë 24.01.2018 dhe Udhëzimi Nr. 31 datë 29.12.2017. Rishikimit të kurrikulës në nivel Fakulteti dhe më pas në bashkëpunim me NJSBC, analizohet dhe merren parasysh propozimet e departamenteve. Personeli akademik bën përditësimet në përmbajtje të programeve të studimit, rishikohen të gjitha syllabuset, sipas përcaktimeve të VKM Nr.41, shtojca 2, (e ndryshuar) duke mundur kështu rivlerësimin e syllabuseve në nivel institucional. Programi Bachelor ka ndryshuar në nivel mbi 20% duke qenë se dy programet e tjera janë hapur rishtazi.</p> <p>Për programin e studimit në Teknikë Dentare me karakter profesional në AI mbetet hapësirë e madhe për përmirësimet të syllabuseve në tematikat e laboratorëve e praktikave për t'ju afruar gradualisht e sa më pranë problemeve të shumëllojta me të cilat konfrontohet tekniku dentar. Rastet e difekteve për të cilat realizohen proteza nga studentët në laborator, vijnë duke u vështirësuar derisa arrihet në raste pacientësh realë. Përzgjedhja e rasteve, shumëllojshmëria e tyre, koha në dispozicion të punimit dhe justifikimi teorik i zgjidhjes janë aspekte shumë të rëndësishme të kurrikulës së këtij programi dhe subjekt i përmirësimit të vazhdueshëm të saj.</p> <p><i>Ref. Dosja e Programit TD. Programi TD. Shembull syllabusi të ndryshuar.</i> <i>Takimi me stafin.</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Departamenti i ortodoncisë është përgjegjës për ofrimin e programit të studimit, administrimin e veprimtarive akademike dhe koordinimin e brendshëm. Departamenti disponon dosjen e plotë të programit të studimit si dhe është përgjegjës për monitorimin e cilësisë së programit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të saj. Përmbajtja e programit mësimor reflektohet në planin mësimor i cili paraqet një informacion të detajuar mbi numrin e Lëndëve,</i></p>



	<p>moduleve, kategorinë nga A-E, numrin e krediteve, orët në auditor dhe jashtë auditorit, tipet e veprimtarive të parashikuara dhe ngarkesën respektive të tyre, rishikimi i syllabuseve/përditësimi i tyre, kryehet në fillimin e vitit akademik.</p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive profesionale drejt punësimit të studentëve.</p>	<p>Duke qenë se programi është hartuar në përputhje me fushën dhe nivelin e studimit në dy vite akademike, studentët në vitin e parë zhvillojnë lëndë bazë më pas kalojnë gradualisht në lëndë më profesionale. Përveç orëve teorike në auditor kanë mundësi të aftësohen në orët e dedikuara posaçërisht për formimin praktik edhe me pacientë realë, si një komponent i rëndësishëm i cili i mundëson atyre një punësim të sigurtë.</p> <p><i>Ref. Programi TD.</i> <i>Takimi me stafin.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>Shpërndarja e lëndëve dhe moduleve realizohet në 2 semestra për 1 vit akademik të ndara në kredite dhe orë mësimore në auditor, laboratore, detyra kursi, praktika profesionale, projekt detyra. I është dhënë prioritet praktikave për të ofruar mundësi të plota dhe të thelluara profesionale në fushën e laborantit dentar si në ambientet e akademisë por edhe jashtë saj në klinika dentare dhe institucione ku janë nënshkruar marrëdhënie bashkëpunimi. Lëndët/modulet, shpërndarja e tyre në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p> <p><i>Ref. Plani mesimor DP TD</i> <i>Takimi me stafin, studentët.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit ka një raport të balancuar midis moduleve/aktivitetëve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimin në praktikë/punë konkrete në profesion. Raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori – praktikë është në përputhje të plotë me profilin e programit të studimit në një raport të balancuar 50:50 sipas kriterëve dhe akteve ligjore në fuqi. Struktura e programit është krijuar duke u bazuar në përvojën e stafit, brenda dhe jashtë vendit dhe është e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p> <p><i>Ref. Plani mesimor DP TD.</i> <i>Takimi me stafin.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas</p>	<p>Studentët formohen paraprakisht konform planit mesimor të vitit të parë në module</p>



<p>veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>si "Anatomia Dentare", Njohuri të Materialeve Dentare Ndihmëse dhe me Biopërshtatshmëri", "Anatomi", "Histologji dhe Biologji e Qelizës", e "Art Modelimi", të cilat mundësojnë gjykimin e saktë mbi formën dhe funksionimin si një kompleks të pjesëve përbërëse të hapësirës orale. Modulet e mëtejshme si "Teknika e Protezave I &amp; II" apo "Teknika e Urave e Kurorave I &amp; II" pajisin studentët me njohuri e aftësi praktike mbi arritjen e formës dhe funksionit të dhëmbëve, përgatitjen e modeleve prej allçie, procedurat e prodhimit të protezës totale të lëvishshme etj, duke krijuar një raport 1:1 të kohës ndërmjet teorisë dhe praktikës gjatë vitit të parë. AI lehtëson punësimin e studentëve në fund të programit të studimit. Njohja e krediteve jashtë vendit nëpërmjet mundësive të transferimit të krediteve në vende ku ofrohen programe studimi të ciklit të parë në fushën e protetikës i jep mundësi studentëve të kenë hapësira të tjera dhe të shtojnë e thellojnë njohuritë e tyre në formimin në vazhdim si brenda dhe jashtë vendit.</p> <p><i>Ref. Plani mesimor DP TD.</i> <i>Takimi me stafin.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse.</p>	<p>Syllabuset përditësohen në mënyrë periodike duke u rishikuar çdo fillim viti akademik. Duke qenë se është një program i ri nuk janë bërë ndryshime përveç dy syllabuseve duke ndryshuar tematikën dhe literaturën. Nevojitet rishikim dhe rivlerësim i syllabuseve në tematikat e moduleve praktike për t'ju afruar gradualisht e sa më pranë problemeve të shumëllojta me të cilat konfrontohet tekniku dentar.</p> <p><i>Ref. Shembull sylabusi të ndryshuar.</i> <i>Takimi me stafin.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.</p>	<p>AI nëpërmjet bashkëpunimeve të ndryshme si brenda por edhe jashtë vendit garanton formimin praktik në përputhje të plotë me kërkesat e profesionit dhe orientimit të studentëve në tregun e punës. Mund të përmendet bashkëpunimi me qendrat e edukimit dentar 3Shape Academy dhe Ivoclar Academy nëpërmjet marrëveshjes me përfaqësuesin e tyre për Shqiperinë, Dorina Mele Co.</p> <p><i>Ref. Marrëveshje Ivodent Trajnime Studentësh nga lektorë të huaj</i> <i>Takimi me stafin</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbytja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës, në përputhje me nivelin 5 të KSHK.</p>	<p>Përmbytja e programit të studimit në Teknikë Dentare në AI ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje edhe me nivelin e ciklit të parë të studimeve, duke krijuar bazat e duhura për një studim me të thelluar në fushën e teknikave dentare. Krahas njohurive shkencore teorike synohet aftësimi praktik i studentëve nëpërmjet laboratorëve dhe praktikave.</p> <p>Synohet që studenti të përvetësojë njohuri shkencore, aftësi praktike duke u mundësuar punësimin të menjëhershëm të studentëve në klinika e laboratorëve brenda dhe jashtë vendit.</p> <p><i>Ref. Programi TD.</i> <i>Takimi me stafin, studentët</i></p>

<b>Konkluzione</b>	<p><i>Programi i studimit është me karakter profesional. Emërtimi është në përputhje me fushën dhe nivelin e studimit. Emërtimi dhe veprimtaritë formuese të programit janë ndërtuar në mënyrë të tillë që të ofrojnë një bazë të gjerë njohurish në fushën e teknikave dentare dhe dentistrisë estetike, që t'ju mundësojnë studentëve punësimin në një shkallë të gjerë. Një nga pikat e forta e Akademisë lvovent është profili i institucionit drejt aplikimeve praktike dhe orientimit të studentëve me tregun e punës. Programi i studimit është organizuar në përmbajtje me qëllim arsimimin profesional dhe kualifikimin shkencor të studentëve në fushën e teknikave dentare.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht <b>X</b>

<b>Standardi II.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Departamenti i Ortodontisë, si njësi përgjegjëse për programin e studimit, është vazhdimisht në marrëdhënie me partnerët, bashkëpunëtorët dhe tregun në përgjithësi, me qëllim përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës. Të gjitha marrëdhëniet e bashkëpunimit kanë patur një ndikim të rëndësishëm në lidhje me hartimin e kurikulës dhe syllabuseve, mësimdhënien, praktikimin e deri në punësimin e studentëve.</p> <p><i>Ref. Analiza e përfitimeve nga Marrëveshjet Institucionale.</i> <i>Takimi me stafin</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimin të programit të studimit.</p>	<p>Kontaktet me studentët ruhen edhe pas diplomimit. Zyra e shërbimit ndaj studentëve, Qeveritë studentore, Studentët alumni japin kontributin e tyre të vlefshëm në lidhje me krijimin e lidhjeve me drejtuesit e laboratorëve si në aspektin e përmirësimin të mësimdhënies, aftësimin praktik por edhe të punësimin. Kështu studentët e diplomuar ndihmojnë më të rinjtë me njohuritë e tyre më të përparuara dhe i ndihmojnë gjatë formimit të tyre.</p> <p><i>Takimi me stafin, studentët</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësi përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me kompani, rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale dhe institucione publike e private.</p>	<p>Departamenti i Ortodontisë, si njësi përgjegjëse për programin e studimit merr në konsideratë zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me institucione publike e private brenda dhe jashtë vendit. Risetë vijnë në AI nëpërmjet ekspertëve më të mirë të fushës së teknikave dentare duke u integruar në programin e studimit e duke u bërë pjesë e punës së studentëve.</p> <p><i>Ref. Programi TD.</i> <i>Takimi me stafin</i></p>

<b>Konkluzione</b>	<p><i>Akademia Ivodent ka një rrjet të gjerë bashkëpunëtorësh me të cilët janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi, kontrata dhe angazhime. Një kontribut të rëndësishëm në përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit luajnë dhe studentët e diplomuar në vite, me të cilët akademia mban kontakte të vazhdueshme. Edhe pse programi akreditohet për herë të parë dhe nuk mund të bëhen ndryshime pa përfundimin e këtij procesi, institucioni ka të përcaktuar në strategjinë e vet, përmirësimin, përditësimin e programit të studimit në përputhje me propozimet e dhëna nga partnerët, bashkëpunorët, studentët e diplomuar dhe ekspertët e fushës së teknikave dentare.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			X	

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Në çdo syllabus është përcaktuar qartë forma dhe metodologjia e mësimdhënies, leksionet, seminarët, detyrat/projektet, punët laboratorike dhe praktikat mësimore e profesionale, të cilat realizohen nëpërputhje me planin mësimor dhe ndryshojnë nga lëndë në lëndë. Hartohet nga titullari i Lëndës dhe respekton lirinë akademike. Syllabuset hartohen në bazë të legjislacionit në fuqi VKM 41 datë 24.1.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë". Raporti teori/praktikë në orët e këtij programi profesional është ruajtur në minimalen që lejon VKM në favor të praktikës meqenëse objektivat dhe misioni i programit lidhen më shumë me aftësimin praktik profesional të studentëve. Lëndët karakterizuese, laboratorët dhe praktikat mësimore janë parashikuar me numër të madh orësh në laboratorët e mire pajisur të Akademisë Ivodent. Në program janë parashikuar edhe praktika profesionale veç atyre laboratorike në bashkëpunim me klinikën dentare për pacientë realë nga tregu. Në takimin me stafin, kuptuam që në përfundim të studimeve realizohet provimi përfundimtar ku secili nga studentët kryen një punim dhe e paraqet para komisionit të vlerësimit.</p> <p><i>Ref. Dosja e Programit TD. Plani mesimor DP TD.</i> <i>Takimi me stafin</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik, personeli ndihmës akademik respektojnë dhe u përgjigjen larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies, personeli akademik përdor forma të ndryshme të mësimdhënies, të cilat mirëprehen nga studentët. Studentët gjejnë mbështetje dhe përkrahje për tu aftësuar nga personeli akademik i angazhuar në programin e studimit i cili ka eksperiencë të gjatë në mësimdhënie, aftësi profesionale të kuptojnë nevojat që kanë studentët dhe të organizojnë veprimtaritë e tyre të procesit mësimor në funksion të përmbushjes së këtyre nevojave. Format alternative të mësimdhënies, mësimnxënies dhe kontrollit të dijeve parashikohen në planet mësimore, programet e moduleve, dhe rregulloren e programit të studimit. Edukimi në distancë u përdor si një formë mësimdhënëse gjatë pandemisë Covid 19. Aktualisht, Akademia Ivodent përdor platformën Google Education, një sistem online që është bërë pjesë e pandarë e Institucionit. Nëpërmjet "Google Classroom" studenti ka akses në leksione, ushtrime dhe literaturë nga librari online, të rishikojë demonstrime praktike që realizohen dhe regjistrohen në laboratorët e Akademisë nën kamera/mikroskop gjatë orëve të laboratorit, si dhe ka mundësinë të komunikojë vazhdimisht me pedagogun për detyra kurse, ushtrime, protokolle të laboratorëve pa qenë prezent në ambjentet e Akademisë. (<a href="https://ivodent.edu.al/student">https://ivodent.edu.al/student</a>). Përveç mësimin në auditor shfrytëzohet hapësira e laboratorëve dhe praktikave mësimore për të realizuar punime protetike në pacientë realë, duke marrë punë të ndryshme nga tregu.</p> <p><i>Ref. Udhezues per mesimdhënie online. Rregullore e Programit te Studimit TD. Plani mesimor DP TD.</i> <i>Takimi me stafin</i></p>

*Ally*

<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik dhe ndihmës akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe pedagogjike, në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësit, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.</p>	<p>I gjithë personeli akademik dhe ndihmës-akademik i angazhuar në AI, ka mundësi të marri pjesë në aktivitete si simpoziume, leksione të hapura, workshope e konferenca, brenda dhe jashtë vendit, të financuar nga Akademia Ivodent ku ka mundësi të krijojë eksperiencë të vlefshme për përmirësimin e kompetencave profesionale didaktike pavarësisht nivelit të programit të studimit.</p> <p>Teknologjitë e reja, salla digitale me 13 pc dhe 1 ekran 82inch, 4 laboratorët me pajisje moderne bashkëkohore, me mikroskope/kamera, sallat e pajisura me videoprojektor për të demonstruar dhe regjistruar punime praktike të cilat lidhen me kompjuterin apo videoprojektorin dhe lejojnë demonstrimin me detaje të punimeve dentare për një numër të madh studentësh biblioteka e cila pasurohet vazhdimisht dhe disponon tekstet e nevojshme për realizimin e programit të studimit, lidhje interneti etj janë në dispozicion të studentëve dhe mundësojnë format bashkëkohore të mësimdhënies. Të gjitha këto mjete, përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie dhe i sistemit të menaxhimit që akademia disponon, mundësojnë rritjen e aftësive didaktike të stafit akademik ndihmojnë personelin akademik për të realizuar në mënyrë sa më të përshtatshme veprimtarinë mësimdhënëse. Personeli akademik i AI përfton edhe trajnime të ndryshme nga 3Shape Academy, Ivoclar Academy, IQE për cilësinë etj., mbi didaktikën e përcjelljes së njohurive të studentëve falë marrëveshjes me Dorina Mele.</p> <p><i>Ref. Strategjia e Zhvillimit të Institucionit AI.</i> <i>Takimi me stafin</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxitin mendimin krijues dhe kritik të student. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Vlerësimi i performancës së stafit realizohet nga NJSBC. Vlerësimet realizohen nga rezultatet e anketimeve me student e staf akademik. Qëllimi është përmirësimi i cilësisë.</p> <p>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në programin e Teknikë Laboratori është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit mendimin krijues dhe kritik të studentëve në përputhje me dhe natyrën e programit të studimit dhe moduleve në veçanti. Testimet realizohen si në teori dhe praktikë të cilat janë edhe një feedback i punës së stafit akademik.</p> <p>Studentët përfshihen në diskutime dhe ballafaqime me pedagogët duke lënë hapësirë për marrjen e mendimit të studentit mbi mënyrat e ndryshme të zgjidhjes së problemeve nëpërmjet protezimit dentar. Rastet konkrete me pacientë realë të sjella në formë video ose të prekura në praktikë është një mënyrë për të përvetësuar më mirë dijet duke i dhënë vlerë profesionit të teknikut dentar dhe rritur respektin e vetbesimit në këtë profesion. Mestudentët e dobët dhe ata që vijnë nga fakultetet ku nuk aplikohen njohuri të avancuara mbi teknikat dentare bëhet punë e pavarur nëpërmjet konsultimeve për sqarime të temave të veçanta kryesisht në Lëndët e vitit të parë ku ofrohen vazhdimisht konsultime në orarin 14-16 në tre ditë të javës.</p> <p><i>Ref. CV stafi akademik PAE TD. CV stafi akademik PAK TD. Lista emërore e personelit akademik DP 21-22. Formular i vlerësimit të performancës.</i> <i>Takimi me stafin</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë</p>	<p>Departamenti dhe NJSBC vlerëson veprimtarinë akademike të personelit akademik, kryen monitorime, komunikime të drejtpërdrejta, pyetësorë etj, në përputhje me misionin dhe qëllimet e institucionit, strategjinë për zhvillim të</p>

<p>periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>tij, si dhe në përputhje me nevojat e mësimdhënies. Vlerësimet e Departamentit dhe NJSBC janë periodike dhe përfshijnë vlerësim të situatës së programit të studimit të Teknikë Laboratori, cilësinë, stafin akademik të rekrutuar, literaturën e re në bibliotekë, rezultatet e arritura të studentëve, marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtarinë kërkimore shkencore. Pas analizës SOWT, merren masa për përmirësime në të ardhmen. Rezultatet e përpunuara të anketimeve diskutohen me gjithë aktorët e përfshirë, studentë, staf, për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies si dhe në mbledhjen e departamentit.</p> <p><i>Ref. Raport NJSBC mbi Anketat. Shembull Ankete studentore.</i> <i>Takimi me NJSBC, stafin.</i></p>		
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik dhe ndihmës akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Departamenti në bashkëpunim edhe me njësitë e tjera të Akademisë, si Senati, Bordi i Administrimit dhe NJSBC, angazhohen nëpërmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. Trajnimet dhe workshopet e shumta që organizon Fakulteti i Teknikave Dentare për personelin akademik dhe ndihmës me lektorë të zgjedhur nga qendra partnere europiane kanë një rëndësi të veçantë drejtim të përmirësimit të mësimdhënies. Aktivitetet përfshijnë tematika që mbulojnë fusha të ndryshme të mësimdhënies në Akademinë Ivodent.</p> <p>Stafi dhe studentët kryejnë trajnime online, përdorin materiale udhëzuese dhe materiale e aparatura të teknologjisë së fundit të cilat mbështesin edhe eksperimentimin nëfushën e mësimdhënies.</p> <p><i>Ref. Plani i aktivitetit 21-22. Udhëzues për mesimdhënien online Trajnime Studentësh nga lektorë të huaj TD.</i> <i>Takimi me NJSBC, stafin.</i></p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Mësimdhënia në programin 2 vjeçar zhvillohet sipas syllabuseve të programit të studimit. Raporti teori/praktikë në orët e këtij programi profesional është ruajtur në minimalen që lejon VKM në favor të praktikës meqenëse objektivat dhe misioni i programit lidhen më shumë me aftësimin praktik profesional të studentëve. Personeli akademik i angazhuar në programin 2 vjeçar të studimit, plotëson kriteret ligjore të kualifikimit të përcaktuara nga ligji. Në veprimtarinë e vet, departamenti dhe NJSBC janë të angazhuar të monitorojnë dhe vlerësojnë veprimtarinë akademike të personelit akademik. Departamenti përmes kontrolleve të vazhdueshme, planit të aktiviteteve të personelit akademik dhe anketimeve të studentëve, në bashkëpunim edhe me njësitë e tjera të Akademisë, siç janë Senati, Bordi i Administrimit dhe NJSBC, angazhohen në përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>

*Ally* *Shelton*

**Standardi III.2**

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.**


Kriteret	Vlerësimi			
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Në rregulloren e Programit të studimit, e cila bëhet publike (ivodent.edu.al) përcaktohen kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale. Po ashtu edhe syllabuset e Lëndëve përmbajnë informacionin e nevojshëm për studentët për detyrimet akademike që ata kanë gjatë zhvillimit të veprimtarive mësimore. Kreditet e fituara pas shlyerjes së detyrimeve akademike semestrale dhe vjetore vlerësohen me notë e cila reflektohet në sistem dhe studenti mund të aksesojë atë në çdo kohë.</p> <p><i>Ref. Rregullore e Përgjithshme Ivodent. Rregullore e Programit te Studimit TD. Programi TD.</i></p> <p><i>Takimi me NJSBC, stafin.</i></p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në javën e parë të semestrit akademik, secili nga titullarët/pedagogët e lëndëve/moduleve të programit mësimor jep informacion studentëve për syllabusin, përmbajtjen e modulit të organizuar në javë, objektivat, rezultatet e të nxënit, literaturën, orët teorike dhe praktike, metodën e vlerësimit, shpërndarjen e ngarkesës, etj. Gjatë bashkëbisedimit me studentët u konstatua që ata janë të mirëinformuar.</p> <p><i>Ref. Fletëpalosje, Broshura dhe Materiale informative. Informim publik në rrjete sociale partnere.</i></p> <p><i>Takimi me stafin, studentët</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara si në teori ashtu edhe në aftësitë praktike.</p>	<p>Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme si p.sh detyra, ushtrime, kuica, projekte laboratorike, provime me shkrim, vlerësime me gojë, vlerësime praktike, punime individuale, kolokiume, prezantime para komisionit, etj.</p> <p><i>Ref. Fletë vlerësimi praktike. Udhëzues studimi për provimin mbi teknikat dentare.</i></p> <p><i>Takimi me NJSBC, stafin, studentët</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Rregullorja e programit të studimit dhe syllabuset e Lëndëve përmbajnë informacionin e nevojshëm për studentët për detyrimet akademike që ata kanë gjatë zhvillimit të veprimtarive mësimore. Raportet mbi pjesën e vlerësimit gjatë gjithë vitit dhe provimit përfundimtar janë të përcaktuara në syllabuset e Lëndëve. Krahas vlerësimit me testim në fund të procesit mësimor, studentët vlerësohen në lëndët e parashikuara me praktika mësimore e laborator, edhe nëpërmjet vlerësimit të protokolleve të punëve laboratorike apo projekteve/detyrave të kursit që ata dorëzojnë.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>



**Standardi III.3**

**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.**


Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Lëndët/modulet vlerësohen nga pedagogu/titullari i lëndës ose nga komisioni i pedagogëve bazuar në syllabusin e lëndës/modulit. Vlerësimi i studentëve realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar. Ai është formal dhe somativ. Provimet kryen sipas një kalendari të provimeve të cilat bëhen të ditura për studentët duke i dhënë edhe kohën e duhur për përgatitje. Në fund të mbylljes së lëndës/modulit studenti vlerësohet me notë.</p> <p><i>Ref. Fletë vlerësimi praktike. Programi TD.</i> <i>Takimi me NJSBC, stafin</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Në AI përdoren forma të ndryshme të vlerësimit. Në provime respektohet sistemi i kodimit. Gjithmonë në çfarëdo lloj forme vlerësimi somativ studenti vlerësohet nga komisioni për të shmangur rastet e vlerësimit subjektiv.</p> <p>Nëpërmjet sistemit të brendshëm elektronik studenti informohet në çdo kohë me rezultatet personale të provimeve/testimeve. NJSBC menaxhon procesin e vlerësimit të cilësisë së provimeve.</p> <p><i>Takimi me stafin, studentët</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Studentët vlerësohen me notë duke marrë edhe kreditet përkatëse të modulit/lëndës në përfundim të saj me një rezultat pozitiv. Studenti është njohur me rregulloren e institucionit/programit e cila parashikon në mënyrë të qartë modalitetin e vlerësimit/pikëzimin që përfshin një shumatore të vlerësimit të vazhdueshëm dhe atij përfundimtar. Pikëzimi përfshin pjesëmarrjen aktive, plotësimin e detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit), kolokiumet/testimet gjatë vitit dhe provimin përfundimtar.</p> <p><i>Ref. Rregullore e Programit te Studimit TD. Programi TD.</i> <i>Takimi me NJSBC, stafin, studentët</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Vlerësimi i kompetencave dhe aftësive të studentit, përveç vlerësimit me pikë/notë, shoqërohet me komente dhe këshilla nga pedagogët të cilat ndihmojnë studentët të përmirësohen në të ardhmen. Studentët ndihmohen dhe ndiqen në vijimësi të mësojnë nga gabimet e tyre, të rrisin performancën në aftësitë e tyre teoriko-praktike.</p> <p><i>Ref. Fletë vlerësimi praktike. Fletë provimi e korigjuar. Ngritje komision provimi. Publikim rezultatesh provimi. Procedura ankimiti note. Takimi me stafin, studentët</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>AI, informon studentët nëpërmjet rregullores ku përshkruhet se nuk lejohet kopja dhe plagjiatura. Studentët mbikqyren nga anëtarët e komisionit dhe sistemit të kamerave për një mbarëvajtje korrekte të provimeve. Kjo e bën më të lehtë jo vetëm monitorimin por edhe transparencën në raste kontestimesh nga studentët. Zbatohet rregullorja e provimit për hyrjen daljen studentëve apo personave të pa autorizuar, respektimin e afatit kohor të përcaktuar për provim si dhe merren masat e duhura për sigurimin e anonimitetit dhe kodifikimit në fletat e provimit.</p> <p><i>Ref. Rregullore e Programit te Studimit TD</i> <i>Takimi me stafin, studentët</i></p>



<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Rezultatet e provimeve u jepen studentëve brenda 5 ditëve. Ato u bëhen të ditura paraprakisht atyre nga komisioni së bashku me komentet përkatëse, përpara se të hidhen në sistem. Nota minimale për të marrë kreditet e modulit është 5 pesa dhe nota maksimale është 10 dhjeta. Vlerësimi i kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve bazohet në meritë. Notat për secilin modul reflektohen në sistem dhe ruhen në dosjet dhe regjistrat përkatëse në sekretarinë mësimore.</p> <p><i>Ref. Publikim rezultatesh provimi. Çelësi i zgjidhjeve të provimit Teknika e protezave II (1).</i></p> <p><i>Takimi me stafin, studentët</i></p>		
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Studentët e ushtrojnë të drejtën e tyre për të rishikuar rezultatin e një vlerësimi duke paraqitur një ankese në Sekretarinë mësimore me anë të një formulari të veçantë, brenda 48 orëve pas shpalljes së notave përfundimtare. Kërkesa/ankimi, shqyrtohet më pas nga komisioni i vlerësimit me vëmendje.</p> <p><i>Ref. Procedura ankimimi note.</i></p> <p><i>Takimi me stafin, studentët</i></p>		
<p><b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Në përputhje me rregulloren ngrihet komisioni i posaçëm i cili shqyrton rastin dhe merr një vendim të drejtë përfundimtar bazuar në atë që studenti meriton. Sekretaria mësimore ndjek, dokumenton dhe arkivon procedurën e përgjithshme deri në ruatjen apo ndryshimin e vlerësimit përfundimtar. Rastet e kontestimeve janë tepër të rralla dhe kjo vlen për tu përmendur.</p> <p><i>Ref. Procedura ankimimi note.</i></p> <p><i>Takimi me stafin, studentët</i></p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Format dhe mënyrat e vlerësimit janë përcaktuar në syllabuset e Lëndëve dhe u bëhen të ditura studentëve që në fillim të programit mësimor. Vlerësimi i njohurive dhe aftësive profesionale, bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloren e programit. Studenti ka të drejtë të njihet me rezultatet e vlerësimit, si edhe komentet/feedback të dhënë nga pedagogu/komisioni. Rezultatet e provimit u bëhen të njohura studentëve nga komisioni në përfundim të provimit me gojë dhe për provimet me shkrim, pas korrigjimit të tyre.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X

<p><b>Standardi III.4</b></p>	
<p><b>Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale tek ato.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje me nivelin e ciklit të parë të studimeve. Krahas njohurive shkencore teorike, programi synon aftësimin praktik të studentëve nëpërmjet laboratorëve dhe praktikave në Institucion apo laboratorë dentarë. Studenti ka mundësi të thellojë njohuritë e tij</p>

	<p>në studime më të avancuara shkencore pas diplomimit.</p> <p><i>Ref. Marrëveshje Ivodent.</i></p> <p><i>Takimi me stafin, studentët</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Studentët përgjatë formimit të tyre mbartin njohuri të gjithanshme ndër to edhe të fushës së artit të komunikimit, teknologjisë së informacionit, humane, sociale. Këto aftësi të veçanta i kanë ndihmuar studentët si gjatë studimeve por edhe më pas në vendet e tyre të punës pasi janë në kontakt të vazhdueshëm me klientë.</p> <p><i>Ref. Punësimi TD 2020-2022.</i></p> <p><i>Takimi me stafin, studentët</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Në përfundim të çdo lënde përmblihen, analizohen e shqyrtohen kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti gjatë formimit të tij profesional. Synohet përmirësimi i rezultateve të provimeve dhe rishikimi i kompetencave. Rimarrja e tematikave të rëndësishme dhe evidentimi i problematikave ndihmojnë studentët për një përgatitje më të mirë dhe pritje për rezultate sa më pozitive.</p> <p><i>Ref. Programi TD.</i></p> <p><i>Takimi me stafin, studentët</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash, të cilat janë të hartuara në programet mësimore. Studentët kanë në dispozicion infrastrukturën e nevojshme për të aplikuar këto kompetenca në laboratorët ku zhvillohet praktika, siç janë laboratorët e protetikës fikse dhe laboratorit i teknikës dixhitale. Studentët aftësohen duke u ndarë në grupë të vogla për të lehtësuar arritjen e kompetencave të mirëpërcaktuara më parë. Studentët që paraqesin vështirësi mbështeten nga pedagogët e tyre për të realizuar punimet e tyre të cilat do të vlerësohen në përfundim të modulit. Ndihmesë të veçantë kanë dhënë laboratorët dentarë ku studentët përfitojnë të përgatisin materiale për persona realë.</p> <p><i>Ref. Raport Infrastruktura 2022. Raporti analitik 21 AI. Raport NJSBC mbi Anketat. Programi TD.</i></p> <p><i>Takimi me stafin, studentët</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Në mënyrë të vazhdueshme në AI, personeli akademik i brendshëm dhe i jashtëm, specialistët e huaj të ftuar nga akademia, realizojnë orë të hapura, konferenca, seminare me tematika me të reja të fundit të shkencës dhe teknologjisë së informacionit duke marrë edhe konsensusin e Departamentit dhe planifikuar edhe një kalendar për këtë qëllim.</p> <p><i>Ref. Leksion i hapur. Trajnime Studentësh.</i></p> <p><i>Takimi me stafin, studentët</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Edhe pse një program me karakter profesional, në çdo Lëndë/modul janë përcaktuar një numër orësh me qëllim formimin teorik të studentëve. Kurrikula e programit garanton marrjen e njohurive të nevojshme në mënyrë që studentët të jenë të aftë të zbatojnë ato në praktikën laboratorike. Ndërthurja e njohurive me praktikën janë në themel të parimeve kryesore që ka programi i studimit. Në këtë mënyrë studenti thellon njohuritë dhe zhvillon aftësitë profesionale e të veçanta në funksion të teknikave dentare. AI me anë të trajnimeve të ndryshme dhe rekrutimit të personelit akademik të kualifikuar dhe me specialitë të fushës u jep mundësi studentëve për mobilitet duke ndërthur format e mësimdhënies.</i></p>



	<i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi III.5</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike.	<p>Provimi përmbyllës i mbrojtjes së diplomës realizohet duke zbatuar rregulloren e programit të studimit. Studenti futet në provimin e diplomës pasi ka shlyer të gjitha detyrimet e tij akademike. Studentët janë të mirëinformuar në lidhje me procedurën, mënyrën e organizimit, kohën në dispozicion, kriteret e vlerësimit si një provim final dhe tepër i rëndësishëm. Kjo procedurë është hartuar qartë dhe është e publikuar në faqen e internetit, nga ku studenti mund ta aksesojnë lehtësisht.</p> <p><i>Ref. Rregullore e Programit të Studimit TD.</i> <i>Takimi me stafin, studentët</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik ndihmojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	<p>Pedagogët përgjegjës të programit të studimit ndjekin studentët për praktikën, projektet/detyrat, përgatitjen për provimin përfundimtar. Ata japin udhëzime përkatëse mbi provimin e diplomës gjatë takimeve informuese që organizojnë me studentët. Gjithashtu zyra e shërbimit ndaj studentëve, ju vë në dispozicion Manuale për përgatitjen e punimeve përfundimtare, nëpërputhje me programin dhe ciklin e studimeve.</p> <p><i>Ref. Udhëzues studimi për provimin mbi teknikat dentare. Website i Programit Profesional.</i> <i>Takimi me stafin, studentët</i></p>
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit përfundimtar bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë vitit/viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	<p>Komisioni i caktuar nga Departamenti vlerëson punimin që studenti ka realizuar gjatë prodhimit të një proteze dentare komplekse, me elemente nga lloje të ndryshme protezash me të cilat studenti është njohur gjatë gjithë veprimtarive të zhvilluara. Pas përgatitjes së punimit në një periudhë 2 javore, ai testohet edhe teorikisht mbi zgjidhjen e propozuar të difektit në rastin e tij specifik.</p> <p>Provimin përfundimtar i teston studentët për disa module që kanë zhvilluar gjatë studimeve.</p> <p>Komisioni i posaçëm ka në përbërjen e tij pedagogë efektive dhe të jashtëm, të fushave të lidhura me teknologjinë dentare.. Studenti në provimin përfundimtar vlerësohet me notë.</p> <p><i>Ref. Ngritje komision provimi. Rregullore e Programit të Studimit TD</i> <i>Takimi me stafin, studentët</i></p>
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit përmbyllës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si	<p>Pedagogu përgjegjës orienton dhe ndihmon studentët në përgatitjen e punimeve individuale. Gjithashtu një pedagog udhëheqës ndjek nga afër praktikën, projektet/detyrat, përgatitjen për provimin përfundimtar. Për provimin përfundimtar organizohen takime informuese mbi mënyrën e organizimit të provimit. Gjithashtu, pedagogët e Lëndëve të cilët do të jenë të përfshira në</p>

<p>dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>provimin final, organizojnë herë pas here takime me studentët për t'i udhëzuar mbi to. Studentëve ju vihen në dispozicion manuale për përgatitjen e punimeve përfundimtare, në përputhje me programin dhe ciklin e studimeve.</p> <p><i>Takimi me stafin, studentët</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni ndihmon studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave të praktikave profesionale dhe fushës së studimit.</p>	<p>AI ka vënë në dispozicion të studentëve infrastrukturën e nevojshme, si dhe staf ndihmës për të asistuar studentët për kryerjen e testeve e analiza materialeve ku mund të testohet sidomos rezistenca e materialeve ndaj temperaturës në kuadër të praktikave profesionale, apo detyrave të kursit, realizimin e protezave të lëvizëshme për pacientë të moshave të treta etj. Mund të përdoren ambjentet e laboratorëve të Akademisë, laboratorët kërkimorë të Qendrës së Studimit të Teknikave por edhe klinikat ndihmojnë në këtë drejtim. Mund të përmendim klinikat Mirora Ngjelina, Dental Center Albania etj.</p> <p><i>Ref. Marrëveshje Ivodent</i> <i>Takimi me stafin, studentët</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të detyrimit përmbyllës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Provimi përfundimtar dhe projekti i diplomimit vlerësohet me notë duke fituar në këtë mënyrë kreditet respektive.</p> <p><i>Takimi me stafin, studentët</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me "Çertifikatë profesionale" ose "Diplomë profesionale" në fushën e arsimimit të kryer, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, pasi studentit plotëson të gjitha kërkesat e procedurës së diplomimit, duke përfshirë 120 ECTS, zyrat përkatëse përfundojnë procedurën zyrtare të diplomimit për studentin, pajisjen e studentëve të diplomuar me diplomë dhe suplement diplome sipas formateve të liçensuara dhe të aprovuara nga MASR.</p> <p><i>Ref. Diploma dhe suplement TD</i> <i>Takimi me stafin, studentët</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Çdo student, me regjistrimin fillestar në Akademi, pajiset me numër unik matrikullimi nga Qendra e Shërbimeve Arsimore që e shoqëron deri në marrjen e diplomës ose çertifikatës. AI arkivon dokumentacionin e studentit pas diplomimit në zyrat e arkivës. Sekretaria mësimore mban regjistrat bazë të studentëve me të dhëna personale të tyre, regjistrin me vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit, si dhe regjistrin e lëshimit të diplomave apo çertifikatave të dhëna mbi diplomën ose diplomat e marra bashkë me suplementin e diplomës etj. Rregjistrat e studentëve plotësohen në formë të shkruar dhe elektronike dhe mbahen në ruajtje të përhershme. Rast pas rasti, lëshohen vërtetime sipas kërkesave specifike të studentëve për efekt dokumentacioni për brenda dhe për jashtë vendit.</p> <p><i>Ref. Rregullore sekretarise mesimore.</i> <i>Takimi me stafin, studentët</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Akademia informon studentët mbi procedurat e mbrojtjes së diplomës me provim përfundimtar bazuar në përcaktimet e rregulloreve përkatëse të programeve të studimit. Institucioni nëpërmjet pedagogëve udhëheqës ndjek nga afër praktikën, projektet/detyrat, përgatitjen për provimin përfundimtar. Studenti shlyen detyrimet akademike vjetore dhe vlerësohet me notë duke fituar në këtë mënyrë kreditet respektive. Më pas ai hyn në provimin përfundimtar. Sekretaria</i></p>

	<p>mësimore mban rregjistrat bazë të studentëve me të dhëna personale të tyre, regjistrin me vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit, si dhe regjistrin e lëshimit të diplomave apo çertifikata të dhëna mbi diplomën ose diplomat e marra bashkë me suplementin e diplomës.</p> <p>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard <b>përbushet plotësisht</b>.</p>		
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
			X

### Standardi III.6

**Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>AI organizon në mënyrë periodike aktivitete trajnimi në fushën e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Këto aktivitete synojnë zhvillimin e stafit në përdorimin e metodave të ndryshme innovative në fushën e mësimdhënies, të përshtatura sipas natyrës së programeve të studimit.</p> <p>Mjediset ku zhvillohet veprimtaria akademike si klasat, laboratorët, janë pajisur me mjetet e nevojshme teknologjike, ambiente për laboratore të degëve të ndryshme, ambiente për bibliotekën, senatin, salla audiovizive, salla kompjuterash, sallë për konferenca, çka mundëson aplikimin e metodave të ndryshme të mësimdhënies dhe praktikës profesionale etj.</p> <p>Personeli gëzon lirinë akademike për të vënë në zbatim shembuj, ide inovative të mësimdhënies, duke sjellë eksperiencë të ndryshme që aplikohen në institucionet partnere.</p> <p><i>Ref. Manual përdorimi paisjes laboratorike. Trajnime Studentësh</i> <i>Takimi me stafin, studentët</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Për sigurimin e cilësisë në mësimdhënie dhe pikave të tjera kritike të cilësisë mësimore, AI dhe NJSBC hartojnë kontrole dhe anketime me studentë dhe stafin akademik të angazhuar në mësimdhënie. Komunikimi i personelit ndihmës-akademik me studentët monitorohet, me qëllim përmirësimin e tij të vazhdueshëm. AI zhvillon në mënyrë të vazhdueshme anketime dhe pyetësorë me studentë. Në fund të procesit analizohen pikat e forta dhe ato kritike të cilat mund të përmiresohen.</p> <p><i>Ref. Rregullore NJSBC. Marrëveshje Ivodent - IQE. Pyetësori i studenteve AI-IQE. Prezantime të temave të ndryshme nga personeli ndihmës akademik.</i> <i>Takimi me stafin, studentët</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Rezultatet e anketave dhe pyetësorëve, bëhen publike në format të dhënash për studentët në stendat informuese dhe në mënyrë digjitale.</p> <p>Analiza ndahet me departamentet dhe dekanatin, në të cilin diskutohet në mënyrë konstruktive për problemet dhe pikat e forta.</p> <p><i>Ref. Raport NJSBC mbi Anketat. Mbledhje personeli akademik për diskutimin e analizës së cilësisë</i> <i>Takimi me studentët</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni,</p>	<p>NJSBC ka marrë rol kryesor promovues në përmirësimin dhe zhvillimin e cilësisë së</p>

<p>nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>mësimdhënies me qëllim krijimin e profesionistit global të teknikut dentar. Si numër i vogël stafi akademik, praktikat e mira, gjejnë mbështetje të shpejtë dhe adaptohen gjithashtu në mënyrë të shpejtë.</p> <p><i>Ref. Vendim i Bordit të Akreditimit për akreditimin Institucional. Vendim i Bordit të Akreditimit për programin TLD.</i></p> <p><i>Takimi me stafin, studentët</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Infrastruktura aktuale që akademia disponon mbështet aplikimin e të gjithë elementëve të nevojshëm mësimore, praktikës profesionale etj.</i></p> <p><i>Për sigurimin e cilësisë në mësimdhënie dhe pikave të tjera kritike të cilësisë mësimore, AI dhe NJSBC hartojnë kontrolle dhe anketime me studentë dhe stafin akademik të angazhuar në mësimdhënie. Rezultatet e anketave dhe pyetesorëve, bëhen publike në format të dhënash për studentët në standat informuese dhe në mënyrë digjitale.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b></p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p><b>X</b></p>

*Ally*

*Lebani*

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

##### Standardi IV.1

**Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional në përputhje me fushën e programit, për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Akademia Ivodent ka rekrutuar staf akademik të brendshëm dhe të jashtëm me kontratë me një formim të duhur teorik dhe praktik. Me një staf interdisiplinar. Akademia ofron cilësi në përmushjen me sukses të moduleve të përcaktuara duke përmbushur plotësisht kriteret ligjore dhe pritshmëritë e studentëve për formimin e tyre të plotë konform kërkesave në treg dhe pritshmërive. Institucionet partnere ndihmojnë stafin akademik full-time dhe part-time, stafin akademik në marrjen e njohurive të reja në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet trajnimeve, specializimeve. Ivoclar, BEGO, Renfert, Rhein83, 3Shape etj. I japin mundësi stafit për trajnime online, literaturë e materiale të tjera interaktive. Prezent ka 1 staf akademik me titullin Profesor, 7 staf akademik me titullin Doktor dhe 10 staf ndihmës akademik, 6 prej tyre me titullin MSc.</p> <p><i>Ref. Marrëveshja MASR - Ivodent. Dokumentacion kualifikimi i personelit të ri ndihmës akademik 22-23. CV stafi akademik PAE TD. CV stafi akademik PAK TD.</i></p> <p><i>Takimi me stafin.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik efektiv përmbush të paktën 70% të ngarkesës mësimore në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, sipas marrëveshjes me MAS. Personeli akademik me kohë të plotë mbulon shumicën e Lëndëve të programeve të studimit në AI.</p> <p><i>Ref. Shpërndarja e orëve TD 22-23.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Stafi akademik përzgjidhet dhe vlerësohet për seriozitet, integritet, profesionalizëm, përkushtim dhe rezultate të matshme cilësore në mësimdhënie dhe kërkim shkencor. Profesionistët me eksperiencë shumë vjeçare në fusha të ndryshme si atë të protezimit dentar, ortodoncisë, shkencës së materialeve dentare, si pjesë e stafit akademik të AI janë pjesë përbërëse të FTD. Stafi akademik me kontratë vjen kryesisht nga IAL me të cilat AI ka marrëveshje bashkëpunimi. Kontratat nënshkruhen nga pedagogët dhe punëdhënësi sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi realizohet në mënyrë korrekte detyrimi financiar.</p> <p><i>Ref. Organigrama dhe Personeli 2022-2023. Listëpagesa e stafit. Shembull kontrate.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedurë rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura dhe që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe</p>	<p>Në përputhje me përcaktimet e Rregullores së Fakultetit në AI ndiqet një procedurë e qartë rekrutimi për staf akademik, ndihmës apo personel administrative. Në faqen zyrtare të AI publikohet nevoja për staf duke shpallur vendet vakante shoqëruar me kriteret dhe dokumentacionin për kandidatët.</p> <p>Njëسيا bazë paraqet kërkesat dhe secili rekrutim bëhet në përmbushje të kriterëve ligjore të përcaktuara në LAL 80/2015 përsa i përket titujve</p>



<p>përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>akademike, statusit dhe ngarkesës mësimore që duhet të përmbushë sipas gradës shkencore, kritereve që ai duhet të plotësojë në perspektivë. Komisioni <i>ad hoc</i> bën seleksionimin me një procedurë transparente për të gjithë kandidatët e mundshëm duke vlerësuar dosjet e paraqitura apo diskutuar në mënyrë të drejtpërdrejtë për të gjykuar mbi aftësitë profesionale, kualifikimet themelore sipas kritereve, kualifikimet shpesh dhe vizionin e perspektives.</p> <p>Ndërsa administratori, kriteret përcaktohen nga administratori i AI. Për punësimin e personelit ndihmës-akademik me karakter mësimor dhe ndihmës-akademik me karakter administrativ, AI zbaton kriteret ligjore në funksion të kërkesave të legjislacionit në fuqi për Arsimin e Lartë, si ligji Nr 80/2015 apo aktet nënligjore për zbatimin e tij duke respektuar në të njëjtën kohë edhe Kodin e Punës.</p> <p><i>Ref. Rregullore Fakulteti Ivodent. Organigrama dhe Personeli 2022-2023. Shembull kontrate stafi. Listëpagesa e stafit. Procedurë punësimi dhe shpallje vakance.</i></p> <p><i>Takimi me stafin, ZBNJ.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike, duke angazhuar 4 Laborantë të përzgjedhur sipas karakteristikave të lëndëve dhe praktikave laboratorike që kryhen në kuadër të këtij programi studimi 3 prej të cilëve janë personel efektiv i FTD dhe 1 i jashtëm. Personeli ndihmës-akademik ka kualifikimin dhe eksperiencë në prodhimin e protezave dentare dhe aparatave ortodontike të parashikuara në program, janë të nivelit të ciklit parë, Master Profesional apo me studime në Shkollën e Mjështërisë në Gjermani në Teknika Dentare dhe me vite pune të konsiderueshme në laboratorët dentar.</p> <p><i>Ref. Organigrama dhe Personeli 2022-2023. Shpërndarja e orëve TD 22-23.</i></p> <p><i>Takimi me stafin.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ.</p>	<p>Organigrama përditësohet vit pas viti. Staf akademik dhe ai ndihmës akademik përcaktohet nëpërmjet shpërndarjes së lëndëve përgjatë semestrave.</p> <p>Të dhënat statistikore për personelin akademik mbahen në Departamentin e Ortodontisë. Staf përditëson dosjet me formimet në vazhdim, botimet dhe i dorëzon në Sekretarin mësimore.</p> <p>Organigrama bëhet e ditur edhe për studentët të cilët njohin stafin administrativ me rolet përkatëse që mbulojnë.</p> <p><i>Ref. Organigrama dhe Personeli 2022-2023.</i></p> <p><i>Takimi me stafin.</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje dhe bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, dhe veprimtari të tjera specifike sipas</p>	<p>Studentët krahas pjesës teorike të programit të tyre formohen duke realizuar praktikën profesionale si në laboratorët e AI, por edhe në laboratorë të ndryshëm brenda dhe jashtë vendit. Këto laboratore nëpërmjet drejtuesve të tyre përfaqësohen nga specialistët më të mirë të cilët bashkëpunojnë vazhdimisht me personelin akademik të AI me eksperiencë të gjatë në punimet protetike me kualifikime të shkëlqyera profesionale e didaktike të programit të studimit. Përmendim këtu laboratorin BIOSA (Frankfurt-Dreieich, Gjermani), Z. Peter Biernacki (BIOSA) me një formim të</p>

*Ally*

*Redon*

<p>natyrës së programit të studimit.</p>	<p>nevojshëm didaktik nëpërmjet shkollës së Mjështërisë dhe të drejtën e formimit të studentëve të teknikave dentare. Përveç bashkëpunimit me përfaqësuesin zyrtar në Shqipëri të kompanive Ivoclar, 3Shape, Exocad, Rhein 83, Renfert etj., ofrohen trajnime të vazhdueshme për stafin akademik dhe ndihmës-akademik, webinarë, literatura dhe materiale të tjera didaktike për tu përditësuar me zhvillimet e fundit të teknologjisë, ka edhe bashkëpunime të tjera me klinika dentare nëpërmjet të cilave, studentëve u vihen në dispozicion raste reale pacientësh gjatë studimit si metoda alternative didaktike.</p> <p><i>Ref. Kontratë për kryerjen e praktikës profesionale. Udhezues për studentet i kryerjes së Praktikes Profesional. Analiza e përfitimeve nga Marrëveshjet Institucionale.</i></p> <p><i>Takimi me stafin, studentët.</i></p>			
<p><b>Kriter 8.</b> Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet për praktikën profesionale, në mënyrë të vazhdueshme dhe me të njëjtat kushte si në laboratorët me moderne të fushës. Ndiqet udhëzuesi i cili ndihmon studentët në realizimin e lëndës së Praktikës Profesionale i cili informon studentët për praktikat që do të kryejnë. Detyrat e kursit janë pjesë përbërëse e praktikës. Ato reflektojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë punimet e studentëve në kuadër të aktivitetit shkencor të cilat vlerësohen më pas nga drejtuesi i laboratorit me dëshminë e punimit të realizuar.</p> <p><i>Ref. Raport Infrastruktura 2022. Plani mesimor DP TD. Kontrate për kryerjen e praktikës profesionale TD.</i></p> <p><i>Takimi me stafin, studentët.</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Ky program studimi përfaqëson një fushë studimore në të cilën Akademia Ivodent ka një eksperiencë të gjatë që prej themelimit të saj në vitin 2004. Stafi akademik efektiv, ai me kontratë dhe personeli ndihmës akademik kanë formimin e duhur teorik dhe praktik, dhe janë interdisiplinar duke dhënë një mbivështrim të nevojshëm të fushës së studimit. Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit përbëhet prej profesionistësh me eksperiencë shume vjeçare në e fushën e protezimit dentar, ortodoncisë, shkencës së materialeve dentare dhe disiplina të tjera që ofrohen gjatë programit. Institucioni përditëson çdo vit akademik organigramën dhe ruanedhe shpërndarjen e detyrave në secilin prej pjesëtarëve të stafit akademik, ndihmës akademik dhe administartiv. Praktika profesionale, në mbështetje të synimit të këtij programi studimi me karakter profesional, zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme dhe me të njëjtat kushte si në laboratorët më modernë të fushës.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

**Standardi IV.2**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.**


Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>GVJ konstaton që AI vë në dispozicion ambiente të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse duke marrë në konsideratë numrin e studentëve dhe natyrën specifike të Programit të Studimit. Auditoret, laboratorët, biblioteka dhe mjediset ndërmjetëse janë funksionale. AI ka investuar ndjeshëm në infrastrukturën për mësimdhënien dhe laboratorët mësimore janë të pajisur dhe kompletuar për zbatimin rigoroz të çdo protokollit për prodhimin e protezave dentare e aparateve ortodontike.</p> <p><i>Ref. Raport Infrastruktura 2022. Verifikimi i kapaciteteve MAS 21-22. Vendim Senati dhe miratim (kuota+kritere) 20-21, 21-22.</i></p> <p><i>Takimi me stafin, studentët</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Në të gjitha ambientet mësimore të institucionit që vizitoi GVJ në aspektin teknologjik, mjediset ku zhvillohet mësimi për këtë program studimi, janë të kompletuara në nivel aparaturash dhe mbulimi informatik. Sallat ku studentët zhvillojnë orët mësimore janë të pajisura me sistem projektimi, video regjistrimi dhe demonstrimi të punimeve në kohë reale, ambjentet janë të mbuluara me WiFi Shërbimet informatike si posta elektronike, magazinimi i të dhënave, klasat virtuale apo dhe shërbime të tjera, ofroreshin nëpërmjet platformës Google Education të cilën Akademia Ivodent e shfrytëzon qysh prej vitit 2020.</p> <p><i>Ref. Raport Infrastruktura 2022. Akt miratimi higjeno-sanitar. Kontratë shërbimi Google Education - Ivodent.</i></p> <p><i>Takimi me stafin, studentët</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë, bazat e praktikës profesionale apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Për zhvillimin e orëve mësimore dhe laboratorike, studentët kanë në dispozicion të gjitha paisjet e nevojshme për të kryer çdo proces. Paisjet dhe aparatet në dispozicion të reja dhe përfaqësojnë modelet më profesionale dhe moderne të mundshme për secilën teknikë që përmendet në programin mësimor. Në sallat mësimore, ofrohen kushte projektimi, regjistrimi dhe prezantimi multimedial.</p> <p><i>Ref. Raport Infrastruktura 2022. Manual përdorimi paisjes laboratorike. Programi TD.</i></p> <p><i>Takimi me stafin, studentët</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>AI vë në dispozicion të studentëve hapësira laboratorike, për të plotësuar të gjithë nevojat e programit të studimit. Studentët e AI kanë të mundur të aksesojnë bibliotekën e cila është e pajisur me 12 njësi kompjuterike në të cilën studentët mund të literaturën apo video demonstrimet e nevojshme për të studiuar në mënyrë autodidakte. Ky ambjent si të gjithë ambjentet e tjera ka akses në lidhje internet me kabëll apo WiFi të sigurt dhe me shpejtësi të lartë.</p> <p><i>Ref. Raport Infrastruktura Digjitale.</i></p> <p><i>Takimi me stafin, studentët</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Institucioni, nisur nga marrëveshja me MAS për staf të reduktuar dhe duke u bazuar në infrastrukturën në dispozicion, ka parashikuar një numër të ulët</i></p>


	<p><i>studentësh në programin e studimit. Akademia ushtron veprimtarinë e saj në 4 objekte të ndërtuara dhe rivlerësuara me materiale cilësore bashkëkohore, të shfrytëzueshme tërësisht vetëm për veprimtarinë mësimore dhe kërkimore shkencore, si dhe administratën dhe plotëson tërësisht nevojat higjiëno-sanitare duke shmangur elementet e rrezikshmërisë. Për zhvillimin e orëve mësimore dhe laboratorike, studentët kanë në dispozicion të gjitha paisjet e nevojshme për të kryer çdo proces. AI vë në dispozicion të studentëve hapësira laboratorike, për të plotësuar të gjithë nevojat e programit të studimit. Studentët e AI kanë të mundur të aksesojnë bibliotekën.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			<b>X</b>	

### Standardi IV.3

**Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies (bibliotekën, mjedise të posaçme).**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni vë në dispozicion tekste bazë dhe literaturë ndihmëse në ambientet e bibliotekës së AI. Megjithëse AI ofron tekste mësimore falas për studentët, literatura plotësuese të fotokopjuar nga akademia, kërkohet përditësimi dhe pasurimi me literaturë e cila lidhet në mënyrë interdisciplinare me fushën e studimit të teknikave dentare në këndvështrimin inxhinierik, teknologjisë së informacionit dhe mjekësor dentar.</p> <p><i>Ref. Fondi i Bibliotekës. Rregullore e Bibliotekës.</i> <i>Takimi me stafin, studentët</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka ka një fond të caktuar librash. Në mjediset e bibliotekës, studentët mund të aksesojnë literaturën e ruajtur në formë elektronike në kompjuterat e bibliotekës, mund të konsultohen online etj. Janë bërë kërkesa për revista dhe literaturë të viteve të fundit.</p> <p><i>Ref. Fondi i Bibliotekës. Librari Online</i> <i>Takimi me stafin, studentët, punonjësi bibliotekës</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka është e pajisur me tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse. Databaza e botimeve që ka akademia është rritur vazhdimisht falë kontributit të personelit akademik i cili në çdo rast, sjell materiale dhe botime shkencore të fundit në formë elektronike për institucionin. Drejtuesit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e artikujve të bibliotekës për të mbështetur programin, përfshirë buxhetin e planifikuar për të.</p> <p><i>Ref. Fondi i Bibliotekës.</i> <i>Takimi me stafin, studentët</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa</p>	<p>AI ofron tekste mësimore falas për studentët, literatura plotësuese të fotokopjuar nga akademia. Bibliotekat online janë të aksesueshme për të</p>

<p>pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>gjithë studentët në çdo kohë.  <i>Ref. Librari Online Kontrate studenti</i>  <i>Takimi me studentët</i></p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentëve.</p>	<p>AI ka një linjë të dedikuar interneti, e cila mbulon me Wi-Fi të gjitha mjediset e godinave me fibër optike duke rritur cilësinë dhe shpejtësinë e komunikimit. AI ofron sallën e bibliotekës e cila është e pajisur me kompjutera pune profesional, me akses ne internet, libraritë online të abonuara nga AI dhe me softuerët e nevojshem për studentët dhe pedagogët në fushën e teknikave dentare.  <i>Ref. Raport Infrastruktura 2022. Fondi i Bibliotekës. Librari Online. Rregullore e Bibliotekës.</i>  <i>Takimi me stafin, studentët</i></p>		
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Orari i bibliotekës dhe sallës së kompjuterave është ai zyrtar por me kërkesë të studentëve ose gjatë sesioneve të provimeve, këto mjedise janë funksionale me orare të zgjatura.  Ndërsa aksesimi në libraritë online është pa limit gjatë gjithë vitit akademik.  <i>Ref. Rregullore e Bibliotekës.</i>  <i>Takimi me stafin, studentët</i></p>		
<p><b>Kriteri 7.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj.</p>	<p>Departamenti i Ortodoncisë nëpërmjet analizës vjetore para fillimit të vitit akademik, konsideron si prioritar zhvillimin dhe pasurimin e fondit të bibliotekës me botimet e reja.  Stafi akademik përditesohet në mënyrë të vazhdueshme për botimet e reja, konferencat apo organizimet të teknikëve dentar pasi fusha e shkencave dentare zhvillohet në mënyrë të shpejtë me teknologji të reja.   <i>Ref. Fondi i Bibliotekës.</i>  <i>Takimi me stafin, studentët</i></p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Institucioni ka në praktikën e tij ofrimin e teksteve mësimore falas për studentët. Këtu përfshihen edhe literatura plotësuese të cilën studentët mund ta printojnë në sekretarinë mësimore pa kosto. Në Akademinë lvodent, personeli akademik depoziton cikël leksionesh të miratuara paraprakisht që u ofrohet studentëve nëpërmjet platformës online, e-mail ose formave të tjera të komunikimit. Orari i bibliotekës dhe sallës së kompjuterave është ai zyrtar por me kërkesë të studentëve ose gjatë sesioneve të provimeve, këto mjedise janë funksionale me orare të zgjatura. Ndërsa aksesimi në libraritë online është pa limit gjatë gjithë vitit akademik. Departamenti i Ortodoncisë nëpërmjet analizës vjetore para fillimit të vitit akademik, konsideron si prioritar zhvillimin dhe pasurimin e fondit të bibliotekës me botimet e reja.</i>   <i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>



**Standardi IV.4**

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se AI disponon system të menaxhimit të informacionit me të cilin administrohet gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre deri në diplomim. Të gjitha proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale të studentëve nga AI kryhen bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe nëpërputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p>Përgjegjëse për të gjithë informacionin dhe dokumentacionin në institucion është Sekretaria mësimore dhe Shërbimeve ndaj studentit e cila për ruajtjen e dokumentacionit, bazohet në aktet rregullatore të institucionit dhe akte të tjera për funksionimin e arkivave.</p> <p><i>Ref. Rregullore sekretarise mesimore. Rregullore per ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit. Udhezues per mesimdhenien online.</i></p> <p><i>Takimi me stafin, studentët</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sistemi u mundëson personelit akademik, ndihmës akademik, administrative dhe partnerëve aksesim funksional për të menaxhuar aktivitetin e tyre në kuadrin e aktivitetit të përgjithshëm të institucionit. Koordinimi i përgjithshëm i aktivitetit për personelin bëhet nga Zyra e Burimeve Njerëzore e cila evidenton ecurinë dhe përcakton pozicionin e punës për stafet përkatëse. Dokumentacioni ruhet dhe mirëmbahet në letër (hardcopy) dhe në version elektronik. Në këtë dokument, parashikohen të gjitha modalitetet e ruajtjes, klasifikimit dhe dhënies së informacionit dhe dokumenteve.</p> <p><i>Ref. Rregullore e Përgjithshme Ivodent. Rregullore e Programit te Studimit TD. Rregullore per ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit.</i></p> <p><i>Takimi me Zyrën e Burimeve Njerëzore</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton që shërbimet e Google Education dhe softuerit të zhvilluar prej tyre, "Portali i Studentit" vihen në dispozicion të stafit dhe studentëve. Këto sisteme janë të shpejta dhe të sigurta, mjaft të dobishme për informimin, organizimin dhe planifikimin e aktiviteteve. Gjithashtu web page i IAL-se është një platformë dinamike, në përditësim të vazhdueshëm që ofron informacion të detajuar lidhur me programet e studimit, strukturën organizative të institucionit, përbërjen e stafit akademik, aktiviteteve të tjera shkencore e sociale, etj. dhe njëkohësisht mundëson shpërndarjen e shpejtë të informacionit mbi aktivitetet e zhvilluara.</p> <p><i>Ref. Kontratë shërbimi Google Education - Ivodent. Website dhe rrjetet sociale.</i></p> <p><i>Takimi me stafin, studentët</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Platforma Google mundëson komunikimin interaktiv dhe shkëmbimin e informacionit midis stafit dhe studentëve. Për këtë përdoruesit (personeli dhe studentët) janë të pajisur me një postë elektronike të adresës së shkollës. Në brendësi të platformës Google Education studentët dhe stafi kanë shërbime të dedikuara komunikimit dhe ndërveprimit personal apo në grup. Strukturat përgjegjëse të ngarkuara me administrimin e sistemit të informacionit janë: Zyra e IT dhe Bordi i Administrimit.</p> <p><i>Ref. Shërbimet digjitale studentore. Broshurë e Google Education.</i></p> <p><i>Takimi me stafin, studentët</i></p>

<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Komunikimi elektronik garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. Ky sistem automatizon procesin e plotësimit të kërkesave të studentëve për dokumenta të caktuara duke inicuar dhe ndjekur procesin deri në fund.</p> <p><i>Ref. Rregullore sekretarise mesimore. Manuali i përdorimit të Portalit të Studentit. Website dhe rrjetet sociale.</i></p> <p><i>Takimi me stafin, studentët</i></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen zyrtare të internetit të njësisë përgjegjëse për programin e studimit.</p>	<p>Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen zyrtare të internetit të ivodent.edu.al. Kjo faqe përditësohet në mënyrë të vazhdueshme dhe të plotë, ku pasqyrohen informacione të dedikuara secilit program studimi që ofron Akademia Ivodent. Faqja e webit është dinamike dhe përkthehet automatikisht në çdo gjuhë sipas konfigurimeve të shfletuesit të përdoruesit.</p> <p><i>Ref. Shërbimet digjitale studentore. Faqja e webit</i></p> <p><i>Takimi me stafin, studentët</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>AI përdor sistem të centralizuar ku për të aksesuar informacionin e nevojshëm, duhet kryer logimi në sistem. Akademia disponon bazë të dhënash në lidhje me regjistrimin e studentëve, numrin e matrikullimit, të dhënat personale, etj, në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe duke respektuar kuotat e kriteret e përcaktuara nga vetë institucioni dhe të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, për programet e studimeve që ofron Akademia Ivodent nxit interaktivitetin midis studentëve dhe pedagogeve por dhe studentëve midis tyre dhe alumni si nxitje e cilësisë dhe nivelit të mësimin por njëkohësisht me rëndësi për krijimin e rrjetit të bashkëpunimeve profesionale.</i></p> <p><i>Faqja e webit ivodent.edu.al përditësohet në mënyrë të vazhdueshme dhe të plotë, ku pasqyrohen informacione të dedikuara secilit program studimi që ofron.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

**Standardi IV.5**

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional.**



Kriteret	Vlerësimi			
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë</p>	<p>GVJ konstaton që AI ka buxhet të pavarur dhe harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e tij për cikël të plotë studimi. Menaxhimi financiar dhe kontributet kryesore janë mundësuar nga shoqëria themeluese, të cilët kanë anëtarë në Bordin e Administrimit të institucionit. AI çdo vit harton një plan buxhetor vjetor i cili diskutohet gjërësisht me të gjithë aktorët e institucionit. Buxheti vjetor miratohet nga Bordi i Administrimit të Universitetit pasi kalon</p>			

studimi.	<p>nëpër disa faza diskutimesh ku paraqiten nevojat dhe shqyrtohen mundësitë. Fillimisht nevojat paraqiten duke plotësuar formularë të standartizuar të cilat dërgohen në njësitë kryesore, njësitë bazë dhe njësitë e tjera. Në këto formularë, mbështetur në planet strategjike të zhvillimit, listohen nevojat për t'ia dërguar rektoratit. Ky i fundit merr vendimin për t'ia dërguar Bordit të Administrimit për miratim përfundimtar. Në buxhetin vjetor në përputhje me nevojat e njërive dhe bazuar në buxhetin e përgjithshëm të akorduar, Bordi i Administrimit bën alokimin e fondeve sipas zërave. Të gjitha marrëdhëniet financiare janë transparente përkundrejt drejtuesve të AI dhe organeve tatimore e audituese në vend.</p> <p><i>Ref. Raporti vjetor 2020-2021, 2021-2022. Marrëveshja MASR - Ivodent. Alokimi i fondeve nga BA. Rregullore Bordit të Administrimit.</i></p> <p><i>Takimi me Zyrën financiare</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucionin GVJ u informua edhe lidhur me financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendëse dhe të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit. Në raportin e auditimit financiar jepen informacione lidhur me politikat dhe masën e tarifave që arketohen nga studentët, mënyra dhe drejtimit e përdorimit të tyre për të gjykuar se burimet financiare përdoren në mbështetjen dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe shërbimeve të tjera për studentët dhe trajtimin e stafit akademik.</p> <p>Aktualisht situata financiare e këtij institucioni është e qëndrueshme dhe bazuar në ecurinë e dy viteve të fundit, premtion një të ardhme të qëndrueshme.</p> <p><i>Ref. Strategjia e Zhvillimit të Institucionit AI (2018-2023). Raporti i auditit. Rregullore Bordit të Administrimit. Relacion nga administratori.</i></p> <p><i>Takimi me Zyrën financiare</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>GVJ u informua që auditimi i përvitshëm, vlerësimi dhe dokumentimi i përgjithshëm i gjendjes financiare dhe efektivitetit financiar për AI bëhet audit i shoqërisë dhe pasqyrat financiare të institucionit bëhen publike çdo vit, së bashku me raportin përfundimtar. Raportet financiare diskutohen në mbledhje Senati të hapur, ku analizohen Pasqyrat Financiare Vjetore, shoqëruar me raportin e lëshuar nga Audituesi i pavarur. Në takim marrin pjesë përfaqësues nga stafi akademik, administrativ dhe përfaqësues të studentëve. Përmbledhja e informacioneve të Pasqyrave Financiare Vjetore, shoqëruar me raportin e lëshuar nga Audituesi i pavarur dhe me vendimin e SA, diskutohen dhe miratohen me vendim të Bordit të Administrimit. Pas këtij momenti, pasqyrat financiare dërgohen në zyrat e tatimeve dhe Qëndrën Kombëtare të Bizneseve (QKB), të cilat më pas publikohen.</p> <p><i>Ref. Mbledhje Departamenti për diskutimin e buxhetit 2022-23. Raporti i auditit. Alokimi i fondeve nga BA.</i></p> <p><i>Takimi me Zyrën financiare</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni të raportojë deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi</p>	<p>Në prag të fillimit të ri akademik, çdo departament raporton te Dekani mbi realizimin e planit të buxhetit për vitin akademik. Në mbledhje diskutohen dhe për nevoja financiare të paparashikuara të cilat shikohen me prioritet, kalojnë për miratim sipas hierarkisë deri në BA, për alokim të shpejtë të fondeve sipas</p>



realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	<p>nevojave të departamenteve për të qenë të përgatitur për vitin e ri akademik.  <i>Ref. Raportim mbi realizimin e buxhetit nga departamenti. Procedure miratim buxheti.</i>  <i>Takimi me Zyrën financiare, stafin</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Sipas Pasqyrës së të Ardhurave dhe të Shpenzimeve Shoqëria Ivodent Shpk ka bilanc financiar pozitiv, çfarë garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe ekzistencën e kapaciteteve financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare në të ardhmen, përmbush nevojat e departamenteve për zhvillimin cilësor të secilit program studimi duke i ofruar kushtet optimale për to.</p> <p><i>Ref. Relacion nga administratori.</i>  <i>Takimi me stafin</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Krijimi dhe përdorimi i burimeve financiare në Akademinë Ivodent bëhet në bazë të një plani veprimi të hartuar nga Shoqëria që mbështet institucionin. Menaxhimi financiar dhe kontributet kryesore janë mundësuar nga shoqëria themeluese, të cilët kanë anëtarë në Bordin e Administrimit të institucionit. Raportimet financiare janë realizuar çdo vit dhe janë vënë në dispozicion të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve sipas formatit të kërkuar prej tyre. Raportet financiare diskutohen në mbledhje Senati të hapur, ku analizohen Pasqyrat Financiare Vjetore, shoqëruar me raportin e lëshuar nga Audituesi i pavarur Shoqëria Ivodent Shpk është gjithmonë garant i ecurisë dhe stabilitetit financiar duke asistuar në kostot infrastrukturore dhe laboratorike Me zhvillimin dhe rritjen graduale të AI, përmbushen nevojat e departamenteve për zhvillimin cilësor të secilit program studimi duke i ofruar kushtet optimale për to. Në çdo rast, para fillimit të vitit të ri akademik, departamentet kryejnë mbledhje për të diskutuar për realizimin e buxhetit të vitit në mbyllje dhe parashikuar nevoja të parashikuara për vitin.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			X	

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve rregullatore, AI harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë në mënyrë të plotë periudhën e studimit në programin e studimit.</p> <p>Ky program studimi pajis studentët me dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale dhe analitike që ata duhet të fitojnë deri në përfundim të tij bazuar rregullorëve.</p> <p>Përcaktimi i kuotave realizohet nga Senati dhe miratohet nga MAS në bazë të kapaciteteve infrastrukturore që Institucioni ka.</p> <p>Pranimi i studentëve në AI bëhet në bazë të kriterëve të vendosura më parë. Në parim AI synon studentë që kanë rezultate të larta. Por për këtë program studimi nuk ka kufizime përsa i përket kriterit të notës mesatare të maturantit.</p> <p>Pranimi në programet e studimit me karakter profesional është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses shkollën e mesme. Ndjekja e aplikimeve realizohet konform afateve të përcaktuara në kalendarin e miratuar nga QSHA dhe RASH, si dhe procedurat e ankimimeve dhe regjistrimeve. Në fund të regjistrimit, studentët pajisen me numër matrikullimi nga QSHA. Informacioni mbi listën e kandidatëve fitues shpallet në faqen e web dhe në ambientet e akademisë. Studentët qysh në fillim të studimeve të tyre njihen me rregulloren, programin, lëndët, modulet, literaturën bazë që pedagogu i rekomandon, praktikat në laboratorët dentarë brenda dhe jashtë institucionit. Studentët pajisen me kartë studenti nga AI. NJSBC monitoron në mënyrë të vazhdueshme cilësinë e mësimdhënies.</p> <p><i>Ref. Rregullore e Përgjithshme Ivodent. Raport Infrastruktura 2022. Verifikimi i kapaciteteve MAS 21-22. Rregullore Fakulteti Ivodent. Verifikim i kapaciteteve - MAS 22-23. Vendim Senati dhe miratim (kuota+kritere) 20-21, 21-22. Rregullore e Programit te Studimit TD.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>AI garanton politika dhe procedura transparente për trajtim të barabartë dhe të drejtë për të gjithë kandidatët dhe studentët në lidhje me procedurat, praktikat e trajtimit të studentëve për regjistrim e deri në përfundim të formimit të tyre, transferimit etj.</p> <p>Kodi i Etikës i hartuar në rregullore nga Këshilli i Etikës bëhet i njohur që në fillim studentëve ku pasqyrohen rregullat, të drejtat, përgjegjësitë dhe penalitet.</p> <p><i>Ref. Rregullore e Përgjithshme Ivodent. Rregullore e Programit te Studimit TD. Kontrate-studenti-TD</i></p> <p><i>Takimi me stafin, studentët.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe</p>	<p>Vendimet e Këshillit të Ministrave apo udhëzimet e MAS merren në konsideratë përsa i përket kufizimeve, kriterëve të pranimit, kuotave të regjistrimit nga AI për programin e studimit.</p> <p>Senati dhe Bordi i Administrimit i Akademisë Ivodent vendos për pranimin e kandidatëve në mbështetje të kapaciteteve dhe kuotave të miratuara paraprakisht nga MAS e cila verifikon kapacitetet pritëse të AI për kuotat e paracaktuara dhe më pas bën miratimin përfundimtar e kuotave.</p> <p>Fillimisht bëhet një renditje e maturanëve mbi bazën e mesatares së shkollës së</p>

udhëzimeve përkatëse.	mesme më pas ndiqen fazat e regjistrimit nëpërputhje me Udhëzimet e MAS. <i>Ref. Verifikimi i kapaciteteve MAS 21-22. Vendim Senati dhe miratim (kuota+kritere)</i> <i>Takimi me stafin, studentët, sekretarinë</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së kurseve profesionale të kryera, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Rregullorja e Fakultetit ka të përcaktuar qartazi kriteret e pranimit dhe përparimit të studimeve tëstudentëve, transferimit nga një program studimi në njëtjetër, njohjes së studimeve të kryera në një program tjetër të plotë ose të pjesëshëm apo edhe i realizuar në kuadër të projekteve tëshkëmbimit. Në faqen zyrtare të AI dhe rrjeteve sociale të Institucionit publikohen informacione të përditësuara dhe studentët e interesuar apo publiku i gjerëmund të marrë informacion në transparencë të plotë.  <i>Ref. Rregullore Fakulteti Ivodent. Rregullore e Programit te Studimit TD.</i> <i>Takimi me stafin, studentët, sekretaria.</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Përveç rrjeteve sociale, faqes së Institucionit, AI vë në dispozicion para çdo viti akademik materiale informuese, si broshura apo fletëpalosje të cilat përditësohen në mënyrë periodike, për të reflektuar zhvillimin e institucionit dhe programet e reja. Si në periudhën e promovimit, por edhe në vazhdimësi, e mbështëtjes ndaj studentit si edhe sekretaria mësimore asistojnë studentët të cilët dëshirojnë të ndjekin studimet në DPTD. AI ka kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.  <i>Ref. Rregullore sekretarise mesimore. Fletëpalosje, Broshura dhe Materiale informative.</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Sipas kriteve të përcaktuara studentët nga shtresat në nevojë, me prindër invalidë, përfitues të asistencës sociale, përfitojnë bursa studimi, reduktim të tarifës në masën 50%. Studentët me mesatare të shkollës së mesme mbi 9 përfitojnë reduktim prej 10% të tarifës. Gjithmonë para fillimit të vitit akademik AI në bazë të rregullores përcakton kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, kuotat përkatëse për të gjitha kategoritë për secilin program studimi të miratuara nga MAS dhe i pasqyron në faqen e shkollës, në ambientet e institucionit. Bëhet renditja dhe kandidatët fitues regjistrohen pranë sekretarisë me dokumentacionet përkatëse.  <i>Ref. Vendim Senati dhe miratim (kuota+kritere) 20-21, 21-22.</i> <i>Takimi me stafin, studentët.</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>Institucioni ka hartuar dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë në mënyrë të plotë periudhën e studimit në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e AI. Sipas këtyre rregulloreve, ky program studimi pajis studentët me dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale dhe analitike që ata duhet të fitonin deri në përfundim të tij. Pranimi i studentëve nis me përcaktimin e kriteve dhe kuotave nga Senati i Akademisë Ivodent, bazuar në kapacitetet infrastrukturore dhe akademike që departamentiv ofruet i këtij programi ka në dispozicion. Në faqen zyrtare të akademisë, të gjithë të interesuarit mund të marrin informacion të zgjeruar mbi programin e studimit, si kriteret përgjithshme dhe të veçanta të pranimit, kohëzgjatja e programit të studimit, tarifa, etj. Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard <b>përmbushet plotësisht.</b></i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1" style="width:100%; text-align:center;"> <tr> <td style="width:25%;"><b>Përmbushet pjesërisht</b></td> <td style="width:25%;"><b>Përmbushet kryesisht</b></td> <td style="width:25%;"><b>Përmbushet plotësisht</b></td> </tr> </table>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>		

*ckj*

*Redu*

**Standardi V.2**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Informacionet studentët i marrin të përgjithshëm nëpërmjet Portalit të Studentit i cili është i aksesueshëm për gjithë të interesuarit, informacion i plotë dhe i hollësishëm lidhur me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Portali i Studentit mundëson një pasqyrë të arritjeve akademike. Krahas portalit, studenti mund t'i drejtohet sekretarisë mësimore dhe zyrës së mbështetjes ndaj studentëve për çdo paqartësi.</p> <p><i>Ref. Rregullore e Programit të Studimit TD. Plani mesimor DP TD. Programi TD.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme nga kurse profesionale të kryera ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>GVJ konstaton që sipas direktivave dhe rregulloreve, çdo student, informohet rregullisht për procedurat dhe afatet e njohjes së diplomës së studimeve të mëparshme. Studentët gjithashtu informohen për njohjen e diplomës bazuar në akreditimin e programit të studimit. Për vetë natyrën e programit, janë të limituara njohuritë që mund të njihen nga studime të mëparshme. Megjithatë, ka patur raste të njohjes së krediteve nga programe si asisitent-dentar.</p> <p><i>Ref. Procedurë e njohjes së krediteve.</i> <i>Takimi me studentët.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Studentët informohen rregullisht në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të tyre në programin e studimit nëpërmjet informacionit të shkruar në syllabuset, rregulloren e programit, broshurën informative të AI etj, si edhe nëpërmjet informacionit të drejtpërdrejtë në ditët e informimit, në fillim të secilës lëndë nga titullari përkatës apo edhe në sekretarinë mësimore.</p> <p><i>Takimi me studentët.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit përfundimtar dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Në programin e studimit Teknikë dentarë në përfundim të studimeve kryhet provimi përfundimtar, sipas së cilit aplikohet kryerja e punëve individuale nga studentët në një periudhë 5 ditore, në përputhje me aftësitë që studentët konsiderohet ti kenë fituar në Lëndë të caktuara të cilat vlerësohen nga një komision. Për mënyrën se si duhet të përgatiten këto punime, studenti merr informacionin e nevojshëm nga pedagogët e Lëndëve.</p> <p><i>Ref. Udhezues për studentet i kryerjes së Praktikes Profesionale. Rregullore e Programit të Studimit TD.</i> <i>Takimi me stafin, studentët.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për</p>	<p>Proçesi inicohet aktualisht nga MAS ku përcaktohen data informimi me maturantët në shkollat e mesme me përfaqesues të AI. Seksionet këshillimore/informuese ofrohen nga një ekip i përzgjedhur tek maturantët e gjimnazeve të shtrira në vendin tonë në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut. Për të gjithë ata që aplikojnë për një program studimi në AI ekziston mundësia e informimit paraprak në faqen zyrtare në internet, në sekretari, apo takime direkt me staf akademik. Informimi vazhdon edhe me studentët e</p>

informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	viteve të para me aktivitete që organizohen nga AI.  <i>Ref. Udhezues studimi per provimin mbi teknikat dentare. Fletëpalosje, Broshura dhe Materiale informative.</i> <i>Takimi me stafin, studentët.</i>		
<b>Konkluzione</b>	<i>Institucioni, nëpërmjet Portalit të Studentit, realizon procedurën e pranimi të studentëve duke siguruar transparencë në lidhje me përparimin akademik të karrierës së studentit. Sipas planit të veprimit të zyrës së mbështetjes ndaj studentëve, synimi i informimit është t'i ofrohet studentëve të ardhshëm objektiva dhe të dhëna faktike në raport me Akademinë Ivodent dhe programin e studimit në veçanti. Informimi i studentëve lidhur me mënyrën e vlerësimit të dijeve dhe aftësive në programin DPTD bëhet nëpërmjet informacionit të shkruar në sylabuset, rregulloren e programit, broshurën informative të AI etj., si edhe nëpërmjet informacionit të drejtpërdrejtë në ditët e informimit, në fillim të secilës lëndë nga titullari përkatës apo edhe në sekretarinë mësimore.</i>  <i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi V.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	GVJ konstaton që informimi i studentëve për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve Teknikë dentare bëhet nëpërmjet faqes në internet të AI, seancave orientuese që synojnë të informojnë studentët e viteve të para. Ata mund të aksesojnë në formatin hardcopy dosjen e programit të studimit pranë bibliotekës.  <i>Ref. Website AI, Website i Programit Profesional. Fletëpalosje, Broshura dhe Materiale informative. Udhezues studimi per provimin mbi teknikat dentare.</i> <i>Takimi me stafin, studentët</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Broshura tutoriale, udhëzues, video virtuale dhe materiale të tjera u vihen në dispozicion në fillim të çdo viti studentëve të këtij programi studimi nga AI. Ata marrin të dhëna mbi modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese, liqensimin, akreditimin, mundësitë e njohjes së diplomës të lëshuar nga AI brenda dhe jashtë vendit. Kjo bën që ata të jenë të mirëinformuar për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.  <i>Ref. Fletëpalosje, Broshura dhe Materiale informative. Website dhe rrjetet sociale</i> <i>Takimi me stafin, studentët</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen	Nëpërmjet Zyrës së Karrierës realizohet mbështetja e studentëve në krijimin e dokumentacionit sa më të përshtatshëm për të konkuruar në tregun e punës. Zyra ndërmjetëson kontaktet dhe i finalizon ato. Ajo disponon edhe statistika në lidhje

institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	me punësimin që laboratorët dhe institucionet bashkëpunuese kanë ofruar për studentët e diplomuar nga AI. <i>Ref. Marrëveshje Ivodent. Punësimi TD 2020-2022.</i> <i>Takimi me stafin, studentët</i>						
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Në AI studentët e marrin informacionin mbi zhvillimin e procesit mësimor të plotë dhe të përditësuar. Studentët i konsultojnë të gjithë burimet e informacionit. Në takimin me ta, studentët demonstrojnë njohje të plotë të informacionit mbi procesin mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet. Ky informim siguron mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe realizimin me sukses të objektivave. <i>Ref. Raport Infrastruktura 2022. Raport Infrastruktura Digjitale.</i> <i>Takimi me stafin, studentët</i>						
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni informon studentët mbi praktikën profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	GVJ konstaton që informacioni në lidhje me praktikën profesionale është i saktë dhe i plotë. Studentët njihen me strukturën e ndarjes së praktikave dhe përgatiten për këtë qëllim. Ata dinë se kur do zhvillohen laboratorët dhe kur do të shkojnë në praktikën profesionale në laboratorët apo klinikat që ofrohen në shërbim të tyre. Studentët në përfundim të praktikave kanë fituar kompetenca profesionale të cilat i ndihmojnë ata në punësimin e tyre. <i>Ref. Fletëpalosje, Broshura dhe Materiale informative. Kontrate për kryerjen e praktikës profesionale TD. Dëshmi javore e Praktikës Profesionale nga Laboratori. Shpërndarja e orëve TD. Plani mësimor DP TD.</i> <i>Takimi me stafin, studentët</i>						
<b>Konkluzione</b>	<i>Akademia Ivodent vë në dispozicion studentëve dhe të interesuarve informacion të gjerë mbi programet e studimit që ofron. Pjesë e informimit janë informacionet e dhëna mbi format e mësimdhënies dhe kryerjes së praktikave profesionale. Gjatë sezonit të provimeve dhe jo vetëm, studentët mund të aksesojnë portalin e studentit me anë të email-t zyrtar dhe të shikojnë në kohë reale notën e vënë nga pedagogu i Lëndës. Për studentë me aftësi të mira kompania Ivoclar ofron mundësi punësimi në laboratorët dhe shërbimet që ajo ofron.</i>  <i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>						
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

#### Standardi V.4

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga programi, si dhe largimet para	AI disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në sekretarinë mësimore. Aty gjenden të dhënat për studentët, dosjet personale të tyre si dhe regjistrat themeltare, ku pasqyrohen të dhënat personale

<p>përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik, në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>të studentëve, numra matrikullimi, forma e studimeve, të dhëna për studimet e mëparshme dhe ecuria nga data e regjistrimit deri në diplomim të studentit, regjistra notash me vlerësimet e fituara nga studenti gjatë kohës së studimeve, fletë provimi dhe punime të studentëve të dorëzuar gjatë studimeve.</p> <p><i>Ref. Statistika</i> <i>Takimi me sekretarinë</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Në takimin e kryer në ambjentet e AI u konstatua që të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit i cili është funksional, i sigurtë, lehtësisht i verifikueshëm për personat e autorizuar. Akademia Ivodent disponon të dhëna mbi ecurinë e studentëve të programit të studimit përgjatë gjithë vitit akademik që nga momenti i regjistrimit deri në diplomim, të dhëna mbi numrin e studentëve që vazhdojnë studimet në programin e studimit si dhe numrin e të diplomuarve etj. Studentët në portal kanë akses të personalizuar për të aksesuar në çdo kohë nga çdo paisje hapësirën e tyre në të cilën mund të njihen me notat, detyrimet financiare dhe të aksesojnë nëpërmjet ndërlidhjeve të gjitha shërbimet e tjera digjitale të ofruara nga AI si platforma e Google Education.</p> <p><i>Ref. Statistika</i> <i>Takimi me sekretarinë, stafin, studentët</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Në AI përgatiten raporte periodikë për studentët që vijnë dhe për ata ekzistues, në të cilët formatohen edhe profilet e studentëve lidhur me cilësinë në hyrje dhe atë në dalje. Dekanati i FTD ushtron kontrolle periodike mbi saktësinë e informacionit edhe nëpërmjet prodhimit të kartës së studentit që kryhet pranë bashkisë Tiranë çdo vit.</p> <p>Gjithashtu pjesë e vlerësimit është audit i jashëm që institucioni organizon në mënyrë të përvitshme.</p> <p><i>Ref. Raporti vjetor. Rregullore sekretarise mesimore. Rregullore per ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit. Raporti i auditit. Rregullore NJSBC.</i> <i>Takimi me sekretarinë</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia përgjegjëse për programin e studimit duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Përgjegjësi i departamentit, koordinatori i programit, vlerëson në mbledhjet e tij në çdo fillim viti cilësinë në hyrje të studentëve të regjistruar në programin e studimit.</p> <p>Meqenëse numri i studentëve është i vogël mbajtja e rekordeve me të dhënat e punësimit është relativisht e thjeshtë. Nga eksperiencia në programin bachelor, të diplomuarit janë punësuar në qendrat e teknologjisë digjitale dentare në Shqipëri dhe Gjermani dhe kërkesa për ta është në rritje.</p> <p><i>Ref. Punësimi TD 2020-2022. Analize e tregut te punes.</i> <i>Takimi me sekretarinë</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Pranë sekretarisë mësimore gjenden të dhënat për studentët, dosjet personale të tyre si dhe regjistrat themeltare, ku pasqyrohen të dhënat personale të studentëve, numra matrikullimi, forma e studimeve, të dhëna për studimet e mëparshme dhe ecuria nga data e regjistrimit deri në diplomim të studentit, regjistra notash me vlerësimet e fituara nga studenti gjatë kohës së studimeve, fletë provimi dhe punime të studentëve të dorëzuar gjatë studimeve. Të qenurit</i></p>

	<p><i>institucion i vogël krijon lehtësira në menaxhimin e veprimtarive dhe monitorimin e tyre në mënyrë të vazhdueshme. Bazuar në rregulloren e institucionit, sekretarisë mësimore dhe rregulloren e NJSBC, AI kontrollon dokumentacionin e sekretarisë dhe mënyrën e arshivimit për regjistrat e të gjitha llojeve si dhe ruajtjen e të dhënave personale e dokumentacionit. Vlerësimi dhe monitorimi është pjesë e punës së përditshme e Departamentit të Ortodoncisë. Meqenëse numri i personelit është i vogël dhe përmasat e strukturës janë të vogla. Shumica e vlerësimeve monitorimeve dhe raportimeve zhvillohen në mënyrë të drejtpërdrejtë. Përgjegjësi i departamentit, koordinatori i programit, vlerëson në mbledhjet e tij në çdo fillim viti cilësinë në hyrje të studentëve të regjistruar në programin e studimit.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard <b>përbushet plotësisht</b>.</i></p>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	
			<b>X</b>	

<b>Standardi V.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Në AI funksionon Këshilli Studentor i Akademisë Ivodent, (KSAI) i cili promovon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të AI, në strukturat mësimore-kërkimore dhe të shërbimeve si dhe funksionon sipas një rregulloreje të posaçme. Zëri i studentëve dëgjohet, mirëpritet pasi AI inkurajon pjesëmarrjen e studentëve në vendimarrje, organizimin e lirë dhe shprehjen e mendimit të tyre, parashikuar kjo shprehimisht në dispozitat e Statutit të AI.</p> <p><i>Ref. Rregullore Këshilli Studentor.</i> <i>Takimi me studentët</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>KSAI si një organizëm i pavaruar nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur është bërë pjesë integrale e institucionit sepse studentët janë të përfshirë në çdo diskutim dhe vendimarrje.</p> <p><i>Ref. Rregullore Këshilli Studentor.</i> <i>Takimi me studentët.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në</p>	<p>Studentët janë të lirë të shprehin mendimet dhe sygjërimet e tyre në lidhje me ndryshimet që ata i konsiderojnë të nevojshme dhe të domosdoshme për rishikimin e hartimit dhe përmirësimit të programit, syllabuseve, procesin mësimor. AI reflekton dhe ndërhyr për të kryer ndryshime pas analizave dhe vlerësimeve me qëllim përmirësimin e</p>



departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	cilësisë. <i>Ref. Statistika Alumni. Rregullore e Programit te Studimit TD Takimi me studentët.</i>		
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Fokusi kryesor i AI është studenti i cili qëndron në qendër të veprimtarisë së saj. Duke patur një numër të vogël studentësh lidhja dhe kontakti i drejtpërdrejtë ndodh që në ditët e para të shkollës. Krijohet një relacion i ndërsjelltë midis stafit akademik dhe administrativ dhe studentëve dhe realizohet një njohje e statusit social, shoqëror e ekonomik e cila bën të mundur të zgjidhen shumica e problemeve që mund të dalin gjatë gjithë vitit akademik. Lidhja e krijuar, ndihmon në fitimin e një besimi reciprok i cili reflektohet edhe në testime, provime, ku studentët rrallë herë mund të kontestojnë rezultatin e marrë në një testim apo provim. <i>Takimi me studentët.</i>		
<b>Konkluzione</b>	<i>Akademia Ivodent i ka dhënë hapësirën e duhur studentëve për të qënë pjesë integrale e institucionit. Në statut, Rregullore dhe në çdo Akt tjetër të institucionit, studentët janë pjesë e çdo diskutimi dhe vendimarrje. Studentët janë të organizuar zyrtarisht në organin përfaqësues të Këshillit Studentor. Ndërkohë, një student është përfaqësues i studentëve në çdo grup pune që lidhet me vlerësimin e cilësisë së institucionit e që realizohet në bashkëpunim me NJSBC. Edhe në këtë vlerësim në kuadër të akreditimit, zëri i studentëve është i përfshirë. Lidhja me stafin akademik dhe administrativ, njohja e problematikave që gjithësecili ka, statusi social, shoqëror e ekonomik, bën të mundur të zgjidhen shumica e problemeve që mund të dalin gjatë gjithë vitit akademik. <i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

#### Standardi V.6

**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Studentët për të marrë informacione paraqiten pranë Sekretarisë, Zyrës së mbështetjes së studentëve. Lidhja kryhet që ditën e parë kur paraqiten në AI dhe vazhdon më tej përgjatë gjithë kohës së studimeve. Studentët marrin të dhëna mbi programin e studimit, orientohen për pyetje të ndryshme që kanë lidhje me studimet e tyre në AI. Ndhimesa dhe orientimi kryhen në kohë reale duke ndihmuar në zgjidhjen e problemeve që mund të paraqesin studentët. <i>Ref. Rregullore sekretarisë mësimore Takimi me sekretarinë</i>

<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Manuali i këshillimit të karrierës është një mundësi njohjeje me AI për studentët që në ditët e para. Të gjithë studentët kanë mundësi të logohen në një platformë/system elektronik i brendshëm për të cilin AI ka bërë një investim të vlefshëm në shërbim të studentëve dhe personelit akademik. Portali i Studentit, Platforma Google/Google Classroom lehtësojnë studentët për informimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p> <p><i>Takimi me stafin, studentët, sekretarinë</i></p>
--	--



<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Studentët e Programit të studimit në Teknika dentare i ofrohet në çdo kohë informacion nga Zyra mësimore, zyra e karrierës. Ato mbajnë statistika mbi numrin e studentëve të diplomuar shoqëruar nga vendi ku ata janë të punësuar dhe karakteristika të punës që ata zhvillojnë. Kontakti është i drejtpërdrejtë, në mënyrë të vazhdueshme dhe periodike. Studentët orientohen, udhëzohen për karrierën profesionale. Shkolla ka në dispozicion politika lehtësuese përsa i përket punësimit të studentëve pas diplomimit në bazë të marrëdhënieve të bashkëpunimit me laboratorët dentare.</p> <p><i>Ref. Marrëveshje Ivodent. Statistika MAS</i> <i>Takimi me sekretarinë, Zyrën e karrierës</i></p>
---	--

<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse</p>	<p>AI ka hartuar strategji në lidhje me punësimin e studentëve që do të diplomohen si Teknikë dentare. Nisur nga përvojat pozitive të programit bachelor edhe për këta studentë do të vijojnë politika të ngjashme për arritjen e objektivave në lidhje me integrimin e studentëve në institucione mikpritëse deri në punësimin e tyre. Dokumentacioni përkatës vihet në dispozicion të studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p> <p><i>Ref. Statistika MAS 20-21. Statistika MAS 21-22. Punësimi TD 2020-2022.</i> <i>Takimi me sekretarinë, Zyrën e karrierës</i></p>
--	---

<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Akademia Ivodent ka të parashikuar në organigramë, Sekretarinë Mësimore dhe Zyrën e mbështetjes ndaj Studentëve e cila është struktura përgjegjëse që të ndihmojë studentët në marrjen e informacionit të nevojshëm mbi institucionin dhe programet e studimit që ai ofron. Studentët logohen në Portalin e Studentit, ku mund të informohen mbi ecurinë akademike të tyre. Punësimi i studentëve në Akademi dhe në struktura të shoqërisë është një mundësi reale për çdo student që kërkon të angazhohet më shumë. Akademia ofron mundësinë e punësimit në pozicione të ndryshme me orare të limituara.</i> <i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>
---------------------------	---

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional në “Teknikë Dentare” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “AKADEMIA “IVODENT”**

**Pikat e forta dhe afirmime**



1. Programi i studimit është hartuar duke u bazuar në nevojat në rritje të laboratorëve dentare në Shqipëri për specialistë të teknikave dentare.
2. Infrastruktura aktuale që akademia disponon mbështet aplikimin e të gjithë elementëve të nevojshëm mësimore dhe të praktikës profesionale.
3. Akademia ofron cilësi në përmushjen me sukses të moduleve të përcaktuara duke përbushur plotësisht kriteret ligjore dhe pritshmëritë e studentëve për formimin e tyre të plotë konform kërkesave në treg dhe pritshmërive.
4. Programi garanton formimin teoriko-praktik në përputhje me kërkesat e profesionit dhe siguron punësim të shpejtë të studentëve

**Pika të dobëta**

1. Rishikimi dhe rivlerësimi i syllabuseve në tematikat e moduleve praktike për t'ju afuar gradualisht e sa më pranë problemeve të shumëllojshme me të cilat konfrontohet tekniku dentar. [Standardi IV.3/Kriteri 1]
2. Kostoja e lartë e materialeve laboratorike nga njëra anë dhe numri i ulët i studentëve paraqesin një rrezik për pamundësi të vijimit për investime dhe zhvillimit të mëtejshëm të infrastrukturës. [ Standardi IV.5/Kriteri 1; kriteri 2]

**Rekomandime**

1. Rritja e numrit të studentëve do të mundësojë gjenerimin e të ardhurave të tjera nga shërbime përkundrejt të tretëve
2. Të bëhen propozime konkrete ndaj institucioneve politike bërëse për promovimin e programit të studimit me karakter profesional në Teknikë dentare duke i orientuar maturantët drejt programeve profesionale.



## **Conclusions of the Evaluation of the study program with a professional character in "Dental Technique" offered by the Institution of Higher Education "IVODENT ACADEMY"**

### **Strengths and Affirmations**



- 1. The study program has been designed based on the growing needs of dental laboratories in Albania for specialists in dental techniques.**
- 2. The current infrastructure that the academy has supports the application of all the necessary teaching and professional practice elements.**
- 3. The academy provides quality in the successful completion of the defined modules by fully satisfying the legal criteria and the expectations of the students for their full training in accordance with market requirements and expectations.**
- 4. The program guarantees theoretical-practical training in accordance with the requirements of the profession and ensures rapid employment of students**

### **Weak points**

- 1. Revising and re-evaluating the syllabuses according to the standards of the literature of recent years in the topics of the practical modules to gradually bring you closer to the various problems faced by the dental technician. [ Standard IV.3/Criterion]**
- 2. The high cost of laboratory materials on the one hand and the low number of students present a risk of impossibility of continuing investments. [Standard IV.5/Criterion 1; criterion 2]**

### **RECOMMENDATIONS**

- 1. The increase in the number of students will enable the generation of other income from services to third parties**
- 2. To make concrete proposals to political institutions for the promotion of the study program with a professional character in dental technology by orienting graduates towards professional programs.**



**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përmbushen plotësisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				<b>X</b>

*Handwritten signature*

*Handwritten signature*